



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – zëvendëskryetar i komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me kryetarin e KDRTSH-së, zotin Leka Bungo, dhe zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm, zotin Martin Leka, për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2022".

2. Seancë dëgjimore me drejtoreshën e Përgjithshme të ATSH-së, zonjën Valbona Zhupa, për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2022".

3. Seancë dëgjimore me drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, zotin Ardit Bido, për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e vitit 2022".

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Flutura Aça, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Kastriot Piroli, Merita Baku dhe Luçiano Boçi.

Mungojnë:

Agron Gjekmarkaj dhe Meri Markiçi.

Të ftuar:

Leka Bungo – Kryetar i KDRTSH –së,

Martin Leka – zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i RTSH-së,

Pandi Madhi – kryetar i Bordit të Administrimit,

Gentian Opre – drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Petro Koçi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot do të zhvillojmë tri seanca dëgjimore.

Seanca e parë do të jetë nga ora 10:00 deri në orën 11:00, me përfaqësuesit më të lartë të Këshillit Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar dhe të vetë Radiotelevizionit, me zotin Leka Bungo, kryetarin e Këshillit Drejtues të RTSH-së, me zotin Martin Leka, zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të RTSH-së dhe me zotin Pandi Madhi, kryetar i Bordit të Administrimit.

Fillimisht do të dëgjojmë nga njeri prej jush, nuk e di se cili do të fillojë, një pasqyrim të buxhetit që është akorduar deri më tani, ndonjë kërkesë për shtesë që keni, të argumentuar, në mënyrë që ne si komision ta regjistrojmë dhe t'ia transmetojmë komisionit përgjegjës për çështjen e buxhetit, Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Mirë se erdhët!

Fjala për ju.

Pandi Madhi – Përshëndetje!

Unë jam Pandi Madhi, kryetari i bordit të administrimit prej disa vitesh.

Meqenëse flitet për çështje financash, unë jam ngarkuar që të paraqes para jush një informacion të shkurtër për atë çfarë ka ndodhur dhe çfarë do të ndodhë në vitin 2022, lidhur me financimin buxhetor që i bëhet RTSH-së, por edhe për disa kërkesa, që duhet të kenë mbështetjen tuaj dhe të parlamentit, për rritjen e shumës së financimit buxhetor, gjithmonë e lidhur me ato zëra të shpenzimeve që parashikon ligji dhe që duhen mbështetur nga ana e shtetit.

Mbështetja buxhetore për katër vjetët e fundit, faktike, ka ardhur në ulje. Në vitin 2017 ka qenë 865 milionë lekë në total, ndërsa në vitin 2021 ka shkuar në 606 milionë lekë, pra vit pas viti ka ardhur me ulje.

Për vitin 2022 parashikimi është rreth 618 milionë lekë gjithsej, gjithmonë flasim me lekë të rinj, për zëra që ju i keni, por unë po i lexoj,

Për shërbimin në gjuhë të huaj dhe jashtë atdheut janë 280 milionë lekë.

Projekte filmike dhe artistike, që kryesisht është festivali i këngës, pjesëmarrja në Eurovizion, si për të rriturit edhe për fëmijët. Javën që vjen zhvillohet Festivali European për Fëmijë, ku ne do të marrim pjesë dhe shpresojmë të marrim një rezultat të mirë, sepse kënga dhe këngëtarja është shumë e mirë, siç thonë, se unë nuk jam specialist i mirëfilltë.

Mbështetja buxhetore, sipas ligjit “Për mediet audiovizive”, është edhe për orkestrën simfonike, e cila është një pasuri kombëtare, por që nuk është financuar asnjëherë në shumën e duhur, minimalisht për pagat e Orkestrës Sinfonike të RTSH-së.

Zëri i fundit që mbështetet nga buxheti i shtetit është ai për projektet teknike dhe për teknologjitë e reja, por që në këtë rast ka të bëjë vetëm me financimin e një pjese të fondeve, që duhen për mirëmbajtjen e rrjetit të digjitalizimit. Pra, edhe për këtë zë të mirëmbajtjes RTSH-ja mbulon pothuajse një të tretën nga të ardhurat e veta. Këto ishin zërat që parashikohen të financohen nga buxheti i shtetit për vitin 2022.

Nisur nga këto shifra dhe nga nevojat që ka institucioni, janë paraqitur pranë jush disa kërkesa shtesë, që lidhen me mbulimin e shpenzimeve për pagat e punonjësve të orkestrës, që është në shumën 10 milionë të rinj, e cila nuk është një shumë e madhe. Deri më tani kjo është përballuar nga të ardhurat e RTSH-së.

Kërkohet diferenca për mirëmbajtjen e rrjetit të digjitalizimit me rreth 60 milionë lekë. Ka edhe një kërkesë, që lidhet me investime në teknologjitë e reja në fushën e arkivës së RTSH-së, që është një pasuri e konsiderueshme dhe që duhet vlerësuar me shumë objektivitet. Kjo kërkon ndërhyrje të menjëhershme, sepse koha bën të vetën. Kushtet në të cilat mbahen sot janë relativisht të mira, por duhet të kalohen në formate të tjera, të transmetueshme në kanalet e RTSH-së.

Gjithashtu, duhen edhe disa teknologji të reja të përparuara në sistemet FM të radios, gjithashtu dhe në disa drejtime të tjera, siç është ndërtimi i një atelie, për të cilën RTSH-ja e ka ndërtesën, por duhen bërë investime që të vihet në gjendje funksionale dhe të jetë një studio ku të organizohen evente dhe ngjarje të rëndësishme të artit, kulturës dhe të të gjitha fushave.

Pra, kërkesa e RTSH-së për shtesë është rreth 470 milionë, nga të cilat 70 milionë janë emergjente, sepse, sipas ligjit, duhet të financohen nga buxheti i shtetit. Po e përsëris janë 10 milionë lekë për pagat e orkestrës dhe 60 milionë, është pjesa e mbetur e paparashikuar, janë për mirëmbajtjen e rrjetit të digjitalizimit.

Situata është e administrueshme, ka një përafrim lidhur me pagesën e taksës së shërbimit të përdorimit të aparateve televizive, 100 lekë që është në faturën e energjisë elektrike çdo muaj. Këta 2-3 muajt e fundit ka një arkëtim, që po u afrohet shifrave që ne parashikojmë, sepse vitet e fundit kemi pasur deficite dhe mosrealizim në këtë zë, të cilat kanë qenë të justifikuar nga situata e krijuar nga tërmeti dhe pandemia. Megjithatë, RTSH-ja ka insistuar që të arrijë treguesit e programuar, që janë të realizueshëm.

Përveç kësaj, ne gjithmonë kemi paraqitur kërkesën për uljen e komisionit, që i lihet OSHEE-së, e cila e mbledh këtë tarifë, nga 10% në 2%. Në asnjë vend në Europë nuk e ka kaq

të lartë tarifën, për shembull, as Italia, e cila e mbledh taksën e RAI-t në faturën e dritave, pra duhet që të ulet. Kjo është bërë vitet e para, që OSHEE-ja të nxitet për të arkëtuar tarifën e aparateve televizive, por tani ka ardhur koha për t'u rishikuar, mund të them që ka kaluar pak koha, sepse u bënë 5-6 vjet që ne insistojmë, sepse kjo i jep RTSH-së një të ardhur shtesë rreth 70-80 milionë lekë të rinj, me të cilat mund të bëhet një investim.

Të ardhurat që parashikohen të investohen për vitin 2022 nga RTSH-ja janë shumë të vogla. Ne akoma jemi duke punuar me buxhetin e përgjithshëm të RTSH-së, të cilin brenda vitit do ta miratojmë. Por është e domosdoshme që këto zëra që parashitrova, në emër të drejtuesve të RTSH-së, të mbështeten nga ana juaj.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Madhi!

Ftoj kolegët të bëjnë pyetje, nëse kanë.

Po, zoti Ajazi dhe pastaj zonja Zhupa.

Besion Ajazi – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar drejtor i Këshillit Drejtues të RTSH-së,

I nderuar zëvendësdrejtor i RTSH-së,

Unë në profesion jam gazetar dhe fillesat e mia i kam pasur në Televizionin Publik Shqiptar, ku kam punuar rreth 2 vjet. E gjej me vend që të ndërhyj dhe të përgëzoj punën që është bërë deri tani nga të gjithë drejtuesit ndër vite të RTSH-së. Nëse marrim vitin 2005, kur unë kam filluar punë, dhe ta krahasojmë me sot është njësoj si të krahasosh natën me ditën. Megjithatë, ka shumë punë për të bërë.

Unë ju përgëzoj për të gjithë punën e mirë që keni bërë deri tani, për kthimin në shina dhe në rrugën e duhur të këtij televizioni. Në gjuhën popullore mund të them që dikur ka qenë një kafaz pëllumbash, ndërsa sot është konkurrent në tregun medietik shqiptar.

Ju përgëzoj për kalimin në kohë, së bashku me homologët e tjerë europianë, të transmetimit nga analog në atë digjital, për krijimin e një pakete të larmishme kanalesh e programacioni dhe për rritjen e cilësisë në transmetim. Por ka edhe problematika, për të cilat duhet të merren masa dhe të rregullohen në të ardhmen, që janë kryesisht në administrimin e buxhetit.

Një problematikë, që nuk lidhet me këtë periudhë që drejton zoti Bungo, për të cilin gëzoj respekt, sepse jemi rritur me filmat e tij, është sjellja jo e duhur e disa prej anëtareve të Këshillit Drejtues të RTSH-së me buxhetin e televizionit. Siç e thashë, unë jam gazetar dhe miqtë më të mirë i kam nga gazetaria, por ka histori që ata fluturonin andej apo këtej me paratë që vetadministrojnë, por edhe buxheti ua jep, bëjnë vakancat e tyre dhe kthehen me filmime

celularësh në Shqipëri. Këto nuk duhet të ndodhin më. Ne si komision përgjegjës jemi këtu që t'ju kërkojmë llogari, por edhe t'ju mbështesim në kërkesat që keni.

Ashtu siç thashë, keni bërë një punë shumë të mirë dhe të shkëlqyer, por duhet të jeni më rigorozë, më kërkues dhe më transparentë me fondet që keni në dispozicion në të mirë të punës suaj, në të mirë të Televizionit, për rritjen e cilësisë së transmetimit dhe programacionit, që vihen në shërbim të qytetarëve shqiptarë.

Në buxhetin e parashikuar shikoj një shifër prej 280 milionë lekësh për diasporën. Më konkretisht dua të di: për çfarë shpenzohen këto lekë ose çfarë do të thotë përkthime në gjuhë të huaj, sepse janë 2,8 miliardë lekë të vjetra?

Faleminderit!

Petro Koçi – Kush do të përgjigjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju kërkoj falje se duhet të kishit folur pas zotit Madhi, por, duke iu përgjigjur pyetjes, mund të shtoni edhe diçka në lidhje me situatën buxhetore, sipas projektfinancimit dhe kërkesave që keni.

Martin Leka – Ju e keni të gjithë materialin, por do të ndalem në 2-3 detaje. Kam një kohë të gjatë që vij në Komisionin e Medies dhe gjithmonë kam qenë i zhgënjyer, sepse, kur ne kërkojmë, nuk ndodh asgjë. Siç e patë edhe nga tabelat, investimet, në të gjitha kuptimet, kanë ardhur në rënie. Por, kjo nuk do të thotë që të tërhiqemi nëse ia vlen.

Shuma për të cilën ju pyetët përmbledh një gamë të gjerë, aty futen transmetimet e radios në disa gjuhë të huaja, është shërbimi satelitor, i cili kushton shumë e të tjera. Sot nuk e kam tabelën me detaje, por të gjitha ato që kemi kërkuar janë të justifikueshme. Mungesa e financimeve buxhetore, mungesa e transparencës në mbledhjen e tarifës së taksës televizive dhe përqindja e lartë që mban OSHEE-ja, prej 10%, nga 2% që duhet të jetë si një shumë normale, përmbledhin ato që ne kërkojmë.

RTSH-ja ka shumë probleme, por nëse do të ishte televizion privat, unë do të mundohesha të ulja diçka nga cilësia, nga numri i punonjësve dhe shumë gjëra të tjera, për të bërë digjitalizimin e arkivës së RTSH-së, e cila me një fond me rreth 100 milionë lekë mund të fillojë nga puna për të ngritur infrastrukturën, për të blerë disa pajisje e të tjera. Arkiva është si ai sonduku apo arka e madhe që kishim në shtëpitë tona për të ruajtur sendet e vjetra, për të cilin ne mund ta falim shtëpinë me të gjitha vetëm ajo të na ruhet. Ky është problem shumë i madh, që ka RTSH-ja. Kjo nuk përkthehet vetëm për të ruajtur memorien e kombit, por përkthehet edhe në vlera, edhe në të ardhura të vetë RTSH-së. Në kuadër të reformimit ne i kemi dërguar një projekt, ndoshta është shumë shpejt Këshilli Drejtues do të miratojë strukturat

e reja, ku është bërë një studim për ngritjen e promocionit të *YouTub*-it dhe rrjeteve sociale, në mënyrë që ne të gjenerojmë të ardhura. Duke pasur një arkivë të tillë, me zëra dhe me pamje që nga dita e parë e krijimit të radios në vitin 1938 dhe më pas në vitet '60 të televizionit, kur këto të bëhen të transmetueshme, pas dixhitalizimit të arkivës, kjo do të sjellë të ardhura shumë të mëdha për RTSH-në, pa diskutim mund t'i kalojë 1 milionë euro në vit që në fillimet e veta. Kaq kisha.

Petro Koçi – Zoti Bungo, ju lutem, na jepni një konsideratë të përgjithshme nga ana juaj për buxhetin.

Leka Bungo – E para punës unë nuk marr vesh fare nga kjo punë.

E dyta, po të flas, do të bëhem qesharak.

E treta, nëse doni mendimin tim për çështje të tjera, që nuk kanë të bëjnë me buxhetin, unë jam dakord.

Petro Koçi – Dakord. Fjalën e ka zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit, zoti drejtues!

Lexova me vëmendje kërkesat që keni sjellë, por nuk mund të lë pa përmendur kërkesën e legjitimitetit që ju keni si Këshill Drejtues i RTSH-së, sepse sot nuk keni përfaqësues të zgjedhur nga opozita dhe funksiononi si një organizëm monokolor, i kontrolluar dhe i dirigjuar nga qeveria. Kjo besoj se duhet të jetë zgjidhja e parë që duhet bërë sa më shpejt edhe nga ky komision. Në këtë komision kanë kaluar 2 kandidatura, zoti Emond Tullumani dhe zoti Besnik Mustafaj, duke marrë miratimin e këtij komisioni, pastaj me të gjithë procedurën e letrave nën rrogoz me pseudopozitën i keni çuar për t'u votuar në seancë, duke kapur kështu edhe Këshillin Drejtues të RTSH-së. Jo se është risi, sepse ashtu janë kapur edhe institucionet e tjera, por kjo duhet të ndreqet sa më shpejt, pasi është një televizion që paguhet nga publiku dhe duhet t'i shërbejë të gjithë publikut.

Tani kthehemi në çështjen kryesore, se si i menaxhoni ju paratë dhe pse doni ju para të tjera nga taksapaguesit, për këtë unë do t'i referohem Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Unë ju them që sot është në burg ish-drejtori dhe disa zyrtarë të RTSH-së, por me atë që bëni ju në RTSH, ju duhet të kishit mbushur qelitë e Burgut 313, me abuzimet që bëhen me paratë e shqiptarëve. Konkretisht, pastaj do të bëj edhe disa pyetje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, po lexoj raportin. Kur të të vijë radha ty, atëherë fol si prokuror apo si të duash. Si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të zyrtarëve dhe punonjësve të RTSH-së është shkaktuar një dëm ekonomik, bëhet fjalë për vitin e kaluar, në shumën prej 237 milionë lekësh,

që përfaqësojnë kryesisht vlera monetare për procedura prokurimi, të zbatimit të kontratave, si dhe për zbatimin e projekteve artistike.

Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe në menaxhimin me ekonomicitet dhe efikasitet në vlerën 922 milionë lekë në zbatimin e procedurave të prokurimit publik nga gjyqet për largimet e padrejta nga puna të punonjësve. Janë konstatuar mungesa të sigurimit të mirëpërdorimit të fondeve publike dhe transparencës për shpenzimet e parashikuara në shumën 1 225 000 000 lekë pa TVSH për tri investime. Po jua them të rrumbullakosura shumë.

Veprimtaria e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar ka shfaqur mangësi në lidhje me hartimin e një kodi sjelljeje. Radiotelevizioni Shqiptar e ka kryer veprimtarinë e tij në mungesë të planeve të zhvillimit, të planeve të biznesit, si një element bazë që ia kërkon statuti dhe ligji “Për prodhimet e programeve dhe transmetimin e tyre”. Bordi i administrimit ka dhënë miratim për të gjitha projektet artistike të paraqitura, sipas propozimit të drejtorit të Përgjithshëm, pa asnjë ndryshim, duke i kaluar ato siç i vinin dhe pa i kontrolluar.

Struktura organike ka pasuar ndryshime të shpeshta, duke mos qenë e konsoliduar, dhe një numër të konsiderueshëm pozicionesh pune, që ndryshonin çdo 6 muaj. Këtë mund t’jua them edhe me përqindje për secilin 6-mujor.

Në RTSH ka një numër të konsiderueshëm të punonjësve organikë, të cilët kanë përfituar njëkohësisht pagë dhe honorare për projekte: 23 në 6-mujorine dytë të vitit 2017, 32 në vitin 2018, 71 në vitin 2019 dhe ka ardhur gjithmonë duke u rritur. I paguani nga dy herë, një herë si këshilltarë, për shembull, dhe një herë për një projekt.

Gjatë zbatimit të projekteve artistike nuk janë vendosur dhe nuk janë zbatuar kritere në lidhje me përzgjedhjen dhe kontraktimin e subjekteve fizikë dhe juridikë për sa i përket statusit të tyre profesional dhe statusit të tyre gjyqësor.

Këto që lexova janë një pjesë e konstatimeve, por kam një raport prej 99 faqesh dhe nuk ka një fjalë të mirë për mënyrën si i menaxhoni ju paratë. I ke aty për secilin tender që ju keni bërë, edhe në periudhën tuaj si zëvendës drejtor, por unë nuk dua ta zgjas mbledhjen e këtij komisioni.

Media ka transmetuar të dhëna alarmante edhe me emra konkretë, por unë nuk dua t’i përmend, sepse nuk kam asgjë personale me ju apo familjarët tuaj, nuse, dhëndër e të tjera, që ju i keni punësuar në Radiotelevizionin Shqiptar. Punësimet nepotike, kushëriri i këtij, burri i atij, vjehri i këtij, shoku i këtij, janë modeli si bëhen punësimet në Radiotelevizionin Shqiptar.

Petro Koçi – Thuhet “burri i saj” dhe jo “burri i atij”.

Ina Zhupa – Këta kanë marrë të gjitha taksat dhe paratë e Radiotelevizionit Shqiptar.

Absolutisht, unë nuk jam fare dakord me atë thoni ju për rritjen e tarifave të qytetarëve, që ju të merrni dhe vidhni më shumë para nga taksat e qytetarëve shqiptarë. Nuk jam fare dakord që juve t'ju rritet buxheti, përkundrazi, bëj thirrje që institucionet e SPAK-ut të mos qëndrojnë thjesht te tenderi i ish-drejtorit dhe mos t'ju lënë vetëm me auditimin e KLSH- së, por t'ju vënë përpara përgjegjësisë ligjore për atë që keni bërë me Radiotelevizioni Shqiptar.

Një regjizor i njohur dhe shumë i respektuar nga unë, tha: “Radiotelevizioni Shqiptar është bërë si një lopë që e mjelin, por tani duan t'i hanë edhe mishin”.

Unë kam dëshirë t'i drejtoj disa pyetje zotit Leka Bungo në lidhje me administrimin dhe buxhetin e Radiotelevizionit Shqiptar.

Pyetjet e mia kanë të bëjnë me qenien tuaj drejtues i Këshillit të Radiotelevizionit Shqiptar, meqë keni mundësi më shumë se çdokush tjetër për të parë si menaxhohen paratë dhe buxhetet e shtetit, por edhe të ardhurat që ju mbliidhni vetë si Radiotelevizion, si dhe me problematikat që ju mund të keni hasur gjatë kohës së ushtrimit të detyrës suaj. Konkretisht, unë dua t'ju pyes për tri gjëra kryesore dhe për atë që thoshte raporti i KLSH-së në lidhje me projektet dhe pastaj ju mund të më thoni edhe gjëra që ne nuk i dimë dhe mund të jenë në interes të publikut. Çfarë është klasifikuar dhe çfarë ka quajtur Radiotelevizioni Shqiptar projekte? Si i japin dhe si është menaxhuar dhënia e këtyre projekteve? Pra, janë thjesht emisione televizive dhe quhen projekte? A prodhojnë diçka të re? A e kanë justifikuar buxhetin që marrin për atë që i ofrojnë publikut?

Gjithashtu, dua t'ju bëj një pyetje në lidhje me të drejtat e transmetimit që Radiotelevizioni Shqiptar ka pasur për ndeshjet e fundit, për kontratën që ka bërë me UEFA-n. Ne të gjithë e kemi parë që ndeshjet nuk i transmetonte vetëm Radiotelevizioni Shqiptar, por edhe një platformë tjetër private. Radiotelevizioni transmetonte vetëm një ndeshje në javë ...

Petro Koçi – Ndeshje të kujt, të Champions-it?

Ina Zhupa – Jo, të Kampionatit European, që sapo mbaroi.

Petro Koçi – Dakord.

Ina Zhupa – Besoj e keni ndjekur. Mendova se ishit ndjekës më të mirë të futbollit.

A e keni parë kontratën? Sa kushton kontrata? Si janë bërë negociatat për këtë kontratë shumë të majme, për të cilën ka shkuar një pjesë shumë e madhe e buxhetit? Në dijeninë time, është 1,8 milionë euro. A keni ju akses për ta parë këtë kontratë, për ta lexuar atë në shqip dhe a ka ardhur përpara jush?

Gjatë ushtrimit të detyrës në funksionin tuaj si drejtues i zgjedhur nga parlamenti, a keni hasur në procedura të dyshimta, që ju gjykoni se mund të kenë shkaktuar një dëm ekonomik për sa i përket buxhetit të shtetit dhe parave të taksapaguesve shqiptarë?

Këto janë tri pyetjet e drejtuara për zotin Bungo, por jeni të lirë të përgjigjet gjithsecili nga ju në lidhje me observimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, jo të miat. Unë ju lexova vetëm një përqindje shumë të vogël.

Për produktin që ofron Radiotelevizioni Shqiptar sot, që është i vetmi televizion që mund të shikohet edhe në fshatin më të largët të Shqipërisë dhe duhet të ishte një aset kombëtar për atë që transmetonte dhe për vlerat që duhet të përçonte, mund të gjykojnë shumë mirë ata që na ndjekin, qytetarët shqiptarë, duke na thënë sa herë e çojnë telekomandën e televizionit në Radiotelevizionin Shqiptar. Sinqerisht ju them, taksa që ne paguajmë për Radiotelevizionin Shqiptar është nga ato taksa që nuk marrin asgjë pas, përveçse ka shërbyer për të pasuruar drejtorin e radhës.

Zëvendësdrejtori, me sa duket, nuk e fshehu ambicien që të kandidonte për drejtor të radhës, kur foli për planet e tij për arkivën dhe digjitalizimin. Mua nuk më interesojnë emrat, por më intereson produkti dhe paratë e shqiptarëve. Ajo që sillni sot si buxhet, për mua është thjesht plani se si ju të keni sa më shumë para për të abuzuar dhe për të mos dhënë asnjë produkt në shërbim të qytetarëve shqiptar.

Faleminderit!

Petro Koçi – U bashkohem edhe unë pyetjeve që zonja Zhupa bëri për ju.

Besoj se konsideratat duhen marrë në një mënyrë më konstruktive, pavarësisht retorikës politike. Mendoj se ne të politikës nuk jemi engjëjt dhe të gjithë djajtë janë mbledhur te Radiotelevizioni Shqiptar.

Disa konsiderata, që edhe justifikohen nga vlerësimet që ka bërë Kontrolli i Lartë i Shtetit, ekzistojnë në ambientet jashtë Radiotelevizionit, sipas të cilave duhet një administrim shumë më i shëndetshëm i financave në këtë institucion, të cilit i është besuar besimi i publikut për të transmetuar në mënyrë të paanshme zhvillimet e gjithanshme në vend, duke filluar nga ato politike dhe gjithë të tjerat.

Sigurisht, është një kosto për çdo familje në Republikën e Shqipërisë, sepse paguan një taksë, e cila, jo se nuk rëndon në xhepin e familjeve, sidomos atyre me të ardhura të ulëta, por ky mirëbesim duhet justifikuar plotësisht.

Kështu që, pyetjet duhet të konsiderohen me qetësi dhe, ju lutem, përgjigjuni. Mbase duhet të rikonsideroni brenda kufijve të projektbuxhetimit të deritanishëm edhe çështjet prioritare, që ju i kërkoni, siç është çështja e digjitalizimit të arkivës, që në të vërtetë është një çështje jo vetëm e një transmetuesi televiziv, por është një çështje kombëtare, siç e tha edhe zoti Leka, sepse bëhet fjalë për një memorie të kombit. Sigurisht, ne do t'i regjistrojmë kërkesat tuaja dhe nuk do të rrimë indiferentë, por në përputhje me kërkesën që të ketë më shumë

integritet në administrimin e financave të Radiotelevizionit Shqiptar, të mund të rishikohen edhe ato çështje prioritare që ju me të drejtë i keni kërkuar edhe në memon që na keni dërguar paraprakisht në komision.

Zoti Bungo, fjala për ju.

Leka Bungo – Faleminderit!

Në fillim, si më i moshuari këtu, do ju jepja një këshillë: zakonisht kafën e pi me ata që vijnë, jo ata që janë të shtëpisë.

Zonja Zhupa bëri disa pyetje, për të cilat është e shqetësuar. Unë mendoj që shqetësimi, jo vetëm i zonjës Zhupa, por edhe nga sa tha zoti Koçi, është pozitiv. Në përgjithësi, një shqetësim të madh e kanë të gjithë njerëzit që e ndjekin Radiotelevizionin Shqiptar, por edhe ata që nuk e ndjekin, për arsyen pse nuk e ndjekin. Pra, shqetësimi është i përgjithshëm.

Sipas mendimit tim, zotëria e lavdëroi punën e Radiotelevizionit pak më shumë se duhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, unë nuk po flas për kritikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj që të gjithë ju bashkë me mua jemi të interesuar që Radiotelevizioni Shqiptar të bëhet sa më i mirë në kuptimin e shikueshmërisë. Është gjynah që të mos bëhet, sepse atë e shikojnë shqiptarët kudo në botë, përveç shqiptarëve që jetojnë këtu. Prandaj, lufta ka qëllim të mirë.

Po filluam me burgjet, siç tha zonja Zhupa, ne duhet të kërkojmë shtesë fondi për të hapur ndonjë qeli, se ato u mbushën, por unë mendoj që ne duhet të propozojmë si ta bëjmë më mirë këtë punë.

Unë kam mendimin që situata në Radiotelevizionin Shqiptar është shumë e keqe. Mendimet e mia i kam shprehur në mbledhjen e Këshillit Drejtues dhe të gjitha janë të regjistruara në kamera, i kam shprehur në Radiotelevizionin Shqiptar në emisionin e lajmeve në një intervistë që zgjati 1 orë, si dhe në një intervistë në shtyp në një revistë.

Pra, unë nuk mund të fshihem duke thënë që nuk jam dakord me ato që kam thënë. Unë jam ai që kam thënë dhe ngul këmbë që të gjithë bashkë, opozita dhe pozita, duhet të luftojmë që ta bëjmë sa më mirë këtë punë.

Po të filloj me inventarin e shkeljeve që bëhen atje, nuk mjafton dëgjesa prej një ore këtu në komision, por unë mendoj që në riorganizimin e Këshillit Drejtues janë bërë disa hapa

pozitivë që institucioni të rimarrë veten në disa drejtime. Unë mendoj që edhe zëvendësdrejtori, që aktualisht bën punën e drejtorit, na ka mbështetur në kërkesat tona dhe kryesisht në kërkesat e mia. Për këto punë, atje unë kam qenë pak më i egër dhe më i rreptë dhe do të jem akoma më i rreptë.

Për sa i përket pyetjes për kontratën me UEFA-n për ndeshjet e futbollit, personalisht nuk di t'i vë emër asaj. Me UEFA-n është bërë një kontratë që në Radiotelevizionin Shqiptar ekziston vetëm në gjuhën angleze. Që këtu fillon humori. Nuk ka përkthim në shqip as në protokoll dhe askund. Këshilli Drejtues, që ka vendosur shumën 1 800 000 euro për t'u paguar, ka ngritur dorën pa ditur anglisht. Kontrata nuk është lexuar. Nuk është ndonjë gjë e madhe, 1 800 000 euro janë.

Tani, pse duhet të ishte në shqip?

Petro Koçi – E kishe në thonjëza fjalinë “Nuk është ndonjë gjë e madhe”, apo jo?

Leka Bungo – Po.

Petro Koçi – Dakord.

Leka Bungo – I nderuar, zoti Koçi!

Unë po i them gjërat ashtu siç i mendoj, kurse ju merrni çfarë të merrni, shtoni qelitë e bëni çfarë të doni, se është puna juaj.

Unë mendoj që ky projekt dhe kjo kontratë është shumë e diskutueshme, shumë e dyshimtë, që fillon nga fakti se nuk është në gjuhën shqipe në Shqipëri. Kjo mua më duket absurde.

Anëtarët e Këshillit Drejtues, kur kanë një projekt përpara, një kontratë me nëntëdhjetë e ca faqe, duhet të dinë çfarë thuhet në pikën 12 në mënyrë që të bëjnë një vërejtje. Unë nuk po them të mos aprovojnë shumën, por të bëjnë një vërejtje. Ata nuk bëjnë dot një vërejtje, sepse nuk dinë anglisht. Këtë kontratë e firmos drejtori i Radiotelevizionit Shqiptar, Thoma Gëllçi, që nuk di anglisht. Kjo është e vërteta. Dokumentet janë atje, arkiva është atje, unë kam dokument nga protokollin që nuk ekziston në shqip.

AMA ka dërguar shkresë zyrtare te ne dhe kërkon të dijë pse është në anglisht dhe kërkon të kthehet në shqip. Tani, 1 800 000 euro për të transmetuar 1 ndeshje futbollit në javë, i bie që transmetimi i një ndeshjeje të kushtojë 41 000 euro.

Ne në Radiotelevizionin Shqiptar kemi 5 vjet pa asnjë program artistik, kurse televizioni Klan ka programe artistike, Top Chanal-i ka programe artistike, ABC-ja, që tani është bërë gjeneralist, se deri dje ka qenë informativ, bën koncerte. Ne bëjmë një Festival të Këngës në Radiotelevizion dhe një koncert për Vitin e Ri. Kjo është historia. Program

permanent për publikun këtu dhe publikun në diasporë ne nuk kemi pasur në këto 5 vjet. Kjo është shumë e thjesht dhe kuptohet vetëm nga struktura.

Në Radiotelevizionin Shqiptar nuk ka asnjë drejtor, përveç drejtorit të Përgjithshëm. Ky është një moment shumë humoristik. Struktura e re është bërë pa drejtorë, ndërkohë që në të gjithë botën ka drejtorë. Nëse vjen një ftesë nga Italia për drejtorin e televizionit, do të thonë, kush është, se nuk ka. Ka përgjegjës njësisish, thua se jemi ministri komunaleje. Drejtori i televizionit quhet përgjegjësi i njësisë, drejtori i informacionit quhet përgjegjësi i njësisë. Pse? Unë e di pse, por mbase e kuptoni edhe ju.

Në Radiotelevizionin Shqiptar është hequr departamenti artistik dhe kulturor. Ka qenë për 50 vjet, por tani nuk ekziston. Unë kam qenë atje drejtor artistik në vitin '92. Jo drejtor artistik që nuk ka, por aty nuk ka një program artistik për fëmijë. E gjitha kjo ndodh, sepse aty nuk ka strukturë.

Këta dy shembuj i solla për t'ju thënë që atje duhet bërë shumë punë për të ardhur te logjika e asaj që të gjithë duam ta bëjmë sa më mirë.

Unë mendoj që zonja Zhupa nuk ka të drejtë kur thotë që pagesa prej 1 mijë lekësh në muaj është shumë. Në Greqi paguajnë 13 euro në muaj, në Kroaci paguajnë 12 euro në muaj. Unë nuk mund ta barazoj me lekë, por me interesin publik, me dëshirat që ka publiku ynë.

Petro Koçi – Besoj se ishte keqkuptim. Ju kërkuat që komisioni që merr OSHEE-ja të ulet nga 10% në 2%, por jo rritje të ...

Leka Bungo – Jo, jo, për mendimin tim ata e marrin padrejtësisht. OSHEE-ja është sekser, merr 10% për të shpërndarë faturën. Janë shumë para. Me ato mund të bëhej një program artistik, por nuk po i hyj kësaj gjëje.

Që ta dini ju, sepse ju e keni me të dëgjuar, kurse unë i kam me letra tashmë, se po bëj 6 muaj atje, i kam marrë, i kam lexuar me shumë vëmendje dhe e njoh shumë mirë situatën. Dikur në këtë komisionin ka pasur deputetë, siç jeni ju sot, që e kanë ngritur në qiell drejtorin e mëparshëm si Pjetri i Madh që erdhi nga Miçigani dhe bëri reformën. Ai bëri anti-reformën më të mrekullueshme që mund të bëhet. Çfarë bëri? Ai bëri 17 kanale televizive të RTSH-së dhe njerëzit thonë: uau, sa i zoti, bëri 17 kanale, se ishin vetëm 2. Kroacia ka 3 kanale shtetërore, Greqia ka vetëm 1, Franca ka 4, ne kemi 17 kanale. Çdo të thotë kjo? Kjo do të thotë se arkivi, siç e tha drejtori i Përgjithshme, është i shkallmuar dhe ky është një problem shumë serioz. Pse? Deri në vitin X materialet janë të patransmetueshme, sepse janë xhiruar me film ose me bosht, që nuk transmetohet dot më, por në ato regjistrime gjenden veprat më të mëdha të artit shqiptar.

Pra, ka ngelur gjysma e tyre, ajo që është bërë mbas dixhitalizimit. Pra, ne kemi një gjysmarkive dhe atë e kemi shkatërruar. Pse? Sepse kemi 17 kanale dhe është hequr drejtoria e programacioneve. Ajo është një administratë humoristike, se është hequr drejtoria e programacionit. Në asnjë vend të botës nuk ka televizion pa drejtori programacioni. Pse e them këtë? Jo se dua ta them, por, për shembull, kanali 10 jep filmin “Furtuna” në orën 15:00, kanali 7 e jep në orën 18:00 filmin “Furtuna”, kanali 3 e jep filmin “Furtuna” në orën 21:00, në darkë dhe njerëzit pyesin: pse vetëm filmin “Furtuna” ka RTSH-ja? Po, pse ndodh kjo? Sepse nuk ka çfarë të transmetojë.

Këtë që po them këtu e kam thënë botërisht, nuk po e them sot për herë të parë, e kam thënë në shtyp, kudo dhe do ta them derisa të ndryshojë situata. E kam kërkuar me këmbëngulje këtë gjë, se kjo situatë më duket për të keqen e televizionit dhe po të ndryshojë është për të mirën e tij. Kjo çështje më duket emergjente. Kjo gjë është bërë në këtë mënyrë për shije personale, private. Unë mendoj se është bërë për të bërë zhurmë, për të thënë që ne po bëjmë çudira, revolucion mediatik. Njësoj si puna e administrimit të strukturave, ku kanë hequr programet artistike, kanë hequr drejtorin artistik, asnjë program për fëmijë. Edhe çfarë ka ngelur? Kontrata për futbollin e të tjera. Nuk e di, por ato çështje i gjykon tjetërkush, unë po them atë që mendoj.

Gjithashtu, mendoj se ka shumë gjëra që kanë filluar të bëhen mirë. Për shembull, një gjë që juve ju intereson ose ju pëlqen më shumë, është informacioni. Unë mendoj se RTSH-ja në këtë pikë ka një balancë shumë të mirë. Ky është mendimi im, mos qofsha i gabuar. Unë i kam ndjekur lajmet dhe Radiotelevizioni Shqiptar ruan një balancë të mrekullueshme në politikbërjen e informacionit. Madje, them se ka televizione private kombëtare, që janë pak më shumë private sesa duhet, për shembull, mbrojnë Leka Bungon më shumë se sa duhet, kurse në RTSH nuk ka diferencë. Unë mendoj se ky është një nga sukseset jo të vogla të RTSH-së.

Plus kësaj, kemi filluar një program artistik, për herë të parë. Kemi bërë ndryshime në disa gjëra. Unë kam bërë propozimet e mia (do e them edhe në fund propozimin tim konkret dhe mbase do të thoni që s’jam mirë), dhe mendoj se duhet të rishikohet statuti. Statuti është bërë në mënyrë...

Petro Koçi - Për shaka: ne që të njohim herët, e dimë që s’ke qenë mirë gjithmonë.

Leka Bungo – Nuk kam qenë mirë, e vërtetë kjo.

Unë kam qenë armik në dispozicion Petro dhe që ta dish, në Këshillin Drejtues ata s’e kuptojnë kur unë u them, jam për ndryshimin. Tani, për ndryshimin është PD-ja, ata e dinë që unë jam i PD-së. Kjo është komedi e madhe, po unë kështu jam!

Tani, të largohemi nga humori dhe të kalojmë te çështja serioze. Ka një çështje për të cilën ju duhet të keni mëshirë për ne, se na keni vënë thikën në grykë për të pasur Kuvendi një kanal televiziv, gjë e cila mua më duket një dëshirë absurde. Ç'punë ka Kuvendi të ketë një kanal televiziv të vetin, kur Kuvendi vetë nuk mblidhet më shumë se 3 muaj në vit dhe 7 muaj rri mbyllur! Për çfarë? Që të punojnë ata njerëzit atje dhe të marrin rrogën, kryeredaktori, përgjegjësi e të tjerët? A ju duket herezi që në kanalin e Kuvendit, që duhet ruajtur dhe është e domosdoshme të futen edhe gjëra të tjera, që të mos ngelet thjesht për Kuvendin? Se është bosh. A e kuptoni se çfarë po them? Është bosh, nuk jepet asgjë, gjithmonë vëmë fotografinë e ndërtesës së Kuvendit, kaq. Po ka një vit kjo punë! Po për çfarë? Është qesharake! Prandaj duhet të ndryshojë, se është bërë me ligj, dhe jeni ju, ata që duhet ta vendosni ndryshimin, po t'ju duket i arsyeshëm.

Petro Koçi - Përmbylleni tani.

Leka Bungo – Mbarova.

Më falni! E di që u zgjata, por në fakt, mëkatin e keni ju, se bëtë shumë pyetje.

Lidhur me problemin tjetër që shtroi zonja Zhupa, unë jam në kundërshtim me mendimin e saj edhe me atë që bën Kontrolli i Lartë i Shtetit, se për mua nuk është edhe krejt pa humor kontrolli i tij, me thënë të drejtën.

Në fakt, sot kam takuar drejtoreshën e auditit, e cila varet nga Drejtori i Përgjithshëm. A ka gjë më humoristike, ajo që duhet të kontrollojë drejtorin varet nga drejtori! E thirra, e takova dhe më tha: unë varem nga drejtori. I thashë: më fal, ke të drejtë. Janë disa gjëra së prapthi, për të cilat mendoj se duhen parë në statutin e RTSH-së. Pra, duhen parë në statutin e RTSH-së dhe këtë detyrë e ka Këshilli Drejtues, që duhet të merret me statutin, t'jua sjellë juve, ta shikoni dhe të vendosni sesi duhet bërë më mirë, këtu është çështja.

Për sa i përket asaj që nisa më lart, ju duhet të dini një gjë, historikisht, këta gazetarët që shikoni në televizionet shqiptarë, të gjithë kanë dalë nga RTSH-ja, duke filluar nga Ardit Gjebrea, Vera Grabocka, Adi Krasta, Reis Çiço, janë të gjithë pjellat e RTSH-së, por kanë ikur të gjithë. Pse kanë iku? Se s'ka para, s'ka pagesa. Tani ne do të bëjmë...

Flutura Açka - Para ka, por janë vjedhur. Pra, ka pasur para, por janë vjedhur. Ky është thelbi.

Leka Bungo – Më falni, nuk po flasim për ato para që janë vjedhur, se për ato e di tjetërkush. Nuk merrem me ato që janë vjedhur, unë merrem me ato para që janë të pavjedhura. Për ato para që kemi, mendoj se përdorimi i tyre duhet rregulluar me vendime ose me ligj, se nuk vjen asnjë artist i shquar, po nuk e pagove dhe ka të drejtë. Unë i pari nuk shkoj. Unë kam bërë një film para 3 vjetësh me dy seri dhe më kanë dhënë 29 milionë lekë të vjetra për dy

filma. Domethënë, 15 milionë lekë për një film, kurse një aktor i humorit, i Portokallisë, që vjen në RTSH, merr 9 milionë lekë për të thënë dy barsoleta në Champions League. Këto janë faktet.

Tani, ne duhet ta ndreqim këtë punë, prandaj thashë nuk jam dakord me zonjën Zhupa. Pse? RTSH-ja i paguan rrogëtarët me pagën mujore dhe është normale, por mendoj që, edhe pse dikush është punonjës i brendshëm, duhet të marrë edhe honorare, por për këtë duhet ngritur një sistem, duhet ndërtuar mekanizmi.

Gjithashtu, ne jemi në proces duke krijuar një trupë permanente, profesioniste me balet, me skenografi, me aktorë, me regjisorë, me bandë, pra një trupë serioze që do të atashohet pranë Radiotelevizionit Shqiptar, për të bërë programet artistike. Po si mund të më vijë aktori në këtë trupë? A e dini sesa është paga jonë më e madhe? 700 mijë lekë të vjetra. Nuk vjen ai për 700 mijë lekë. A e dini sesa e paguan Portokallia? 3 milion e gjysmë. Nuk jam këtu për të thënë se duhet ta paguajmë 4 milionë. Jo. Unë mendoj se, nëse një aktor e ka pagën 700 mijë lekë (se pagat janë që në kohën e Adil Çarçanit), ne të marrim një vendim, që sipas performancës, këta aktorë sipas vlerës të shpërblehen, kur performojnë. Pra, të kenë bukën e siguar, e zëmë 500 apo 600 lekë të vjetra. Atëherë, nëse artisti i ka këto 600 mijë lekë, kur të bëjë koncertin, të ngrihet mekanizmi që të paguhet, për atë që ka bërë dhe ta zëmë nga 600 mijë lekë t'i shkojë rroga 2 milionë. Po flas me hamendja për këtë pjesë, por kjo gjë duhet bërë, ndryshe në RTSH do të vazhdojmë të bëjmë emisione direkte, që nuk na i ndjek askush.

E fundit që kam për të thënë, është shumë e trishtë, por dua ta them, mendoj që Radiotelevizioni Shqiptar duhet të mbyllet për 6-muaj, që të gjithë punonjësit të largohen me ligj dhe të rikthehen vetëm ata që duhet të rikthehen, si dhe të mos rikthehen ata që nuk duhet të rikthehen. Kjo praktikë ka precedentë, ka ndodhur në Greqi para 3 vjetëve dhe unë kam qenë atje, kam takuar njerëzit për këtë punë atje dhe më kanë sqaruar sesi ka funksionuar mekanizmi. Këtë gjë e ka bërë edhe Spanja para 7 vjetësh. Unë mendoj se te ne kjo gjë është e domosdoshme dhe se duhet një periudhë 6-mujore për të ngritur komisione serioze, profesionale për gazetarinë, për krijimtarinë, për kamerën që të bëjnë audicione serioze profesionale, që të punojnë atje.

Sot, aktualisht kemi 1150 punonjës, nga të cilët 300, po të dilni nga këtu tani, i keni në kafene. Minimumi po them 300, sa që shpeshherë kam unë turp kur i shikoj, se ata nuk para turpërohen. Kështu që, unë mendoj se një operacion i tillë është shumë i vështirë, është i dhimbshëm, por është i domosdoshëm, që të mos bëjmë sikur bëjmë reforma, të gjitha të tjerat, për mendimin tim janë arna.

Unë mendoj që, nëse ju si komision, po e them në thonjëza, “doni të hyni në histori për një revolucion të vërtetë në media”, ky është rasti. Kjo gjë do kurajë, do besim, do profesionalizëm dhe përgjegjësi dhe kjo gjë bëhet vetëm me ligj.

Për shembull, nëse ata njerëz do të ikin 6 muaj nga puna, do të paguhen, sepse pastaj kemi probleme sociale. Ata do e marrin rrogën, se edhe tani e marrin rrogën, ama, ta dimë që pas 6 muajsh do të kemi një RTSH, e cila do të bëjë atë që duhet të bëjë. Më falni, se u zgajta shumë!

Kaq kisha për të thënë.

Petro Koçi - Faleminderit!

Pa dashur kaluam në një analizë të të gjithë Radiotelevizionit.

Leka Bungo – Po vetë m’i bëtë pyetët. Unë vetëm u përgjigja pyetjeve që bëtë.

Petro Koçi – Në fakt, mbledhja është për buxhetin, kryesisht. Patjetër që ka elemente të tjera që kanë lidhje me performancën dhe me mënyrën se si funksionon Radiotelevizioni dhe do të jenë prezentë në diskutimet tona, në pyetje, por edhe në përgjigjet, por gjithsesi, mendoj se duhet të përqendrohemi më shumë te buxheti.

Ndoshta në një mbledhje tjetër të komisionit, do të na duhet të shqyrtojmë edhe këto idetë radikale, që mund të kenë lidhje me transformimin e mëtejshëm të Radiotelevizionit.

E kanë kërkuar fjalën, zonja Buxheli në fillim, pastaj zonja Aça.

Lindita Buxheli – Kërkoj ndjesë, se erdha pak me vonësë!

Me sa dëgjova, mbështetja buxhetore për vitin 2021 ka qenë 606 milionë lekë, në mos gaboj, për vitin 2022 janë parashikuar 618 milionë, domethënë 12 milionë më shumë. Sipas analizave që keni bërë, ju kërkoni 470 milionë lekë. Ne kemi dëgjuar disa institucione, do të dëgjojmë dhe të tjera dhe në fund do të dalim me një material përmbledhës. Themi këtu që do t’ju miratojmë 470 milionë, është një rutinë që e kemi bërë çdo vit, siç tha edhe zotëria, që i shënojmë këtu, ia çojmë Komisionit të Ekonomisë dhe kaq. Por, siç dihet, ka një tavan shpenzimesh dhe nëse u shtojmë 470 milionë lekë në zërin e të ardhurave, duhet të rriten edhe taksat, se ju e dini shumë mirë që për 470 milion lekë i bie të kemi rritje taksash. Atëherë unë mendoj se që në këtë 470 milion lekësh ju të vini një prioritet, që të mos ta shtojmë në letra dhe pastaj të dalim zero. Na thoni kë keni prioritet, që ne si komision ta miratojmë, ta relatojmë në Komisionin e Ekonomisë, që të jemi me këmbët në tokë.

Ndërsa për sa i përket pjesës së auditimit, unë jam vetë audituese dhe nuk them dot nëse në televizion janë shpërdoruar paratë apo jo, sepse duhet të kem të gjithë bazën ligjore të RTSH-së, që të dal në një konkluzion. Nuk e kam këtë gjë, kështu që nuk mund të them për momentin, nëse ka pasur abuzime apo jo. KLSH-ja, nëse konstaton shkelje, i çon në prokurori,

për të cilat mund të dalësh me faj, mund të dalësh pa faj. Ne s'jemi as prokurorë, as gjykatës për të gjykuar këtë pjesë.

Ndërsa për pjesën e buxhetit, na jepni një prioritet, që ta miratojmë të gjithë si komision.

Ky është mendimi im.

Petro Koçi – Kush do të përgjigjet?

Pandi Madhi - Do përgjigjem unë, meqenëse lidhet me buxhetin.

Atëherë, edhe në materialin që ju është paraqitur, janë shkruar edhe kërkesat më emergjente, që janë në zbatim të ligjit për mediat audiovizive dhe lidhen me orkestrën dhe me mirëmbajtjen e rrjetit të dixhitalizimit. Kjo është detyrë e shtetit, që duhet ta përballojë. Këto të dyja janë më emergjentet, pastaj nëse shikohet mundësia për një investim në arkivin e RTSH-së, do të ishte një gjë mjaft e mirë për ta mbrojtur atë arkiva.

Pra, prioritet janë orkestra dhe mirëmbajtja e rrjetit të dixhitalizimit, këto të dyja.

Për sa i përket buxhetit të RTSH-së, do të flas shumë shkurt, pa dashur të bëj debat, që të dini se çfarë përmban buxheti ynë apo se ku shkojnë të ardhurat e RTSH-së. 40% e tyre shkojnë për paga dhe sigurime shoqërore, 25% të tjera shkojnë për pagesa të shërbimit të mirëmbajtës, të organizmave ndërkombëtare që janë fiks të përcaktuara, janë përcaktuar nga marrëveshje ndërkombëtare, nuk i bën RTSH-ja, pra ajo që mbetet për t'u diskutuar janë projektet filmike dhe artistike që vitin 2021 gjithsej janë 316 milionë lekë. Pra, nga i gjithë buxheti prej 2 miliardë e 456 milionë lekësh të rinj, vetëm 316 milionë lekë janë për projekte filmike, artistike dhe investime nuk ka fare për këtë vit. Investime mund të jenë 30 milionë lekë të rinj, nuk ka të tjera, se nuk kishim mundësi, aq është buxheti.

Në lidhje me bordin e administrimit, dua të them se nuk ka detyra administrimi, por ka detyra të tjera, që nuk dua t'i përmend, sepse ia kemi bërë të gjithë observacionin Kontrollit të Lartë të Shtetit, i kemi çuar edhe fakte për ato që ka bërë bordi, edhe kundërshtime kur ka qenë e nevojshme. Bordi është për ato detyra që i cakton ligji.

Këto kisha për të thënë.

Faleminderit!

Petro Koçi – Zonja Açka, pastaj zoti Boçi.

Flutura Açka - Faleminderit!

Më vjen mirë që po diskutojmë këtë çështje, se të paktën për mua, personalisht, Radiotelevizioni Shqiptar është shumë i rëndësishëm.

Me thënë të drejtën, unë jam rritur në Radiotelevizionin Shqiptar dhe kam hyrë aty në vitin 1991, kur ka qenë drejtues një zotëri shumë i pasionuar, Ylli Pepo, të cilit i uroj shëndet.

Në atë kohë ka pasur disa studio, edhe studioja e mëngjesit ka qenë një studio e bukur, e vogël, ndërsa, tani kur shkoj në Radiotelevizionin Shqiptar, është një studio e stërmadhe me disa zgëqe të vegjël. Shkoj tek emisioni “Artes” ka një zgëq, shkoj tek emisioni i Preç Zogajt ka një zgëq, isha mbrëmë tek emisioni “Dekalog” kishte një zgëq. Madje mund ta them me trishtim, që studioja ku kam folur mbrëmë, vura re se nuk kishte as linoleumin të rregullt, por e kishte të copëzuar, e kishte gropa. Ai linoleum bën vetëm 5 mijë lekë të rinj, 50 mijë të vjetra, sa jam gati t’u bëj thirrje kolegëve të mi, këtu në komision, t’i mbledhim ato 50 mijë lekë, që të paktën të mos shkojmë deri në këtë pikë në Radiotelevizionin Shqiptar. Më erdhi trup mbrëmë. Më erdhi turp si njeri që jam rritur në Radiotelevizionin Shqiptar, se kam një ndjeshmëri dhe një dhimbje shumë të madhe ndaj tij, edhe si qytetare, por edhe si deputete e Partisë Demokratike.

Mbrëmë kam folur në një debat, në një studio televizive ku linoleumi ka qenë i dëmtuar, i grisur, sikur e kishin ngrënë qentë. Deri këtu ka mbërritur Televizioni Shqiptar. Gjëja e vetme që ka ndodhur nga ajo kohë, është mbyllja e gropës së madhe që ka qenë para se të hyje në parkim, vetëm kjo gropë është mbushur, pjesa tjetër nuk ka ndryshuar. As roje nuk ka, që të shërbejë aty, as citofoni nuk ka, që të lidhet me gazetarët asgjë, vetëm sa është vendosur një pjesë pllakash me shkëlqim dhe s’ka ndryshuara asgjë. Ndoshta ndonjë gjë e vogël fare ka ndryshuar, kur në fakt, Televizioni ka qenë një lubi e marrjes, e thithjes së parave, të taksave të shqiptarëve.

Duam apo s’duam ne, Televizioni është kthyer në fole, se kur analistët, shokët tanë, pushohen nga puna nga ndonjë televizion privat, u gjendet menjëherë vendi i punës, brenda 24 orëve në Radiotelevizionin Shqiptar. E tillë fole është kthyer Radiotelevizioni Shqiptar, që të jemi të sinqertë.

Zoti Bungo, faleminderit për panoramën që bëre!

Unë nuk mund të them asnjë fjalë më shumë, thjesht po bëj disa shtesa të vogla, sepse ju bëtë një panoramë të saktë. Televizioni Shqiptar është në një moment të trishtueshëm, që është fytyra e këtij shteti, fytyra e artit shqiptar, e medias shqiptare, është në këtë katandi.

Kam vetëm një pyetje, nuk dua të zgajtem shumë, për çështjen e honorareve që e ceku pak edhe zoti Bungo. Në të gjithë botën, kur shkohet në televizionin kombëtar publik, çdo njeri që shkon, sidomos njerëz që kanë njëfarë autoriteti, shkon dhe merr honorarin, i kalon me bankë apo i jepet zarfi, s’ka rëndësi. Kur do të fillojë Televizioni Shqiptar t’i trajtojë njerëzit siç duhen trajtuar? Sepse është televizion publik, nuk është televizion privat dhe ka detyrimin e honorarit për njeriun që fton në studio, në çfarëdolloj programi, qoftë në debatet politike,

qoftë ne debate të tjera. Në të gjithë botën paguhet kjo dalje. E keni të përfshirë ju këtë gjë, kur ju vijnë njerëzit? Prandaj ka arritur këtu cilësia e televizionit.

Për herë të parë mbrëmë, se unë edhe e fus ndonjë herë kokën nëpër televizione, nuk kam marr asnjë mesazh. Domethënë, audienca ka qenë zero. E turpshme! Unë kam ndier turp mbrëmë, që nuk kam marrë asnjë mesazh në një emision të rëndësishëm, ku flisja për politikën, për çështje të ditës. Ky është Televizioni Shqiptar dhe ky është trishtimi im.

Petro Koçi – Zoti Leka, do të jepni ndonjë përgjigje për këto që tha zonja Açka? Shkurt, ju lutem!

Martin Leka - Të gjitha këto janë një oponencë e mirë, sigurisht na shërbejnë edhe neve, me një ndryshim shumë të madh, që nga jashtë mund të duket kështu, por nga brenda duhet ta njohësh mirë situatën, sepse radiotelevizioni është një lubi e madhe me 1000 probleme. Për shembull, për të blerë sot një laps nuk mjaftojnë 2 apo 3 javë. Nuk është kaq e thjeshtë situata. Zonja Açka ka shumë të drejtë për këtë pjesë, por edhe televizionet e tjera, mesa di unë, kanë kontrata me ata që janë të ftuar nëpër emisione, zakonisht nuk e kemi të parashikuar, që t'i japim honorare klasës politike, për hir të së vërtetës.

(Deputetja Flutura Açka flet pa mikrofon.)

As Lulzim Bashës nuk do t'i japim honorare, as Edi Ramës.

Petro Koçi – Analistët e përhershëm kanë kontratë.

Urdhëroni, zoti Boçi!

Luçiano Boçi – Faleminderit, drejtues i mbledhjes!

Faleminderit drejtuesve të RTSH-së!

Momenti i buxhetit është shumë i rëndësishëm, sepse ju si drejtues duhet të zbërtheni para komisionit politikat e RTSH-së, në bazë të financimeve që ju atashohen dhe unë nuk dëgjova asgjë nga këto, dëgjova vetëm dy prioritete, të cilat janë prioritete relative.

Prioriteti i parë ishte mirëmbajtja e digjitalizimit dhe pjesa tjetër çështja e arkivit. Me zotin Leka jemi takuar disa herë në komision dhe për mua është bërë refren çështja e arkivit, sepse është kërkuar disa herë që të mos marrim gjëra të vjetra dhe t'i sjellim këtu si të reja, meqenëse ndryshojnë edhe deputetët në vazhdimësi të legjislativave.

(Diskutime në sallë.)

Për mua, politikat e Televizionit duhej të ishin të qarta sot në lidhje me programacionin, synimet, informacionin, shikueshmërinë, transmetimin, sepse ky është buxheti. Paratë përdoren për këto politika, ndërkohë që dëgjojmë gjëra formale këtu dhe kjo është shumë e çuditshme.

Kjo do të thotë se nuk ka asnjë lloj parapërgatitjeje dhe ky është një tjetër tregues që shpreh situatën skandaloze, korruptive në RTSH.

Çështjen e akuzave që janë ngritur, unë e kam ndjekur. Ja, kjo është ajo studioja e “Agros” që ka kushtuar aq milionë, se ma kanë nisur me foto. Kjo është 2 milionë euro, por nuk është thjesht çështja e një drejtuesi, e mënyrës së drejtimit, sepse, në bazë të statutit që unë e kam debatuar në këtë komision, dhe e di mirë, përgjegjësi ka edhe Këshilli Drejtues i RTSH-së. Ku kalohet një shumë, shuma e harxhuar duhet të aprovohet nga ky këshill, sikurse edhe bordi i administrimit. Të dy duhet të aprovojnë shumën e vënë në dispozicion për blerjen e pajisjeve, hapjen e kanaleve etj..

Jam solidar me ju që buxheti është i vogël dhe sigurisht që ka një sy që shkelet që ju të mos mbështeteni, sepse te ju gëlon korrupsioni, por nuk e bërtasin dot, se pështyma e vet u bie në fytyrë. Ju nuk jeni të saktë as në shifra, sepse Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ka sjellë një tjetër shifër këtu. Financimi është 567 milionë dhe jo 618 sa është projektuar, ndërkohë që mungojnë 38 milionë nga viti i kaluar.

Te një pasqyrë që ky institucion ka përgatitur, duket që mbështetja dhe përkrahja për RTSH-në është në rënie, por nuk është në rënie vetëm si braktisje. Të mos harrojmë që momenti i digjitalizimit ishte momenti crucial i arsyes për të ngritur punën e RTSH-së. Janë hedhur miliona euro për rrjetet frekuencore, që situata të mos ishte kjo që diskutojmë.

Do para Televizioni apo nuk do para Televizioni? Ato miliona euro që u hodhën për rrjetet frekuencore duhej të ishin kthyer në miliona të ardhura për Televizionin dhe jo të vijë Televizioni këtu për lëmoshë për të kërkuar 100 milionë lekë për arkivin apo 60 milionë lekë për mirëmbajtjen e rrjeteve frekuencore, ndërkohë që në kontratën me ndërtuesin e rrjeteve frekuencore e keni të zgjatur në kohë mirëmbajtjen dhe e përballon ai; është bërë debati në këtë komision dhe unë kam qenë prezent.

Duhet parë termat e kontratës, se, me sa shoh unë nga parashtrimet e zotit Bungo, nuk shihen termat e një kontrate për të drejtat televizive, jo më të shihen termat e një kontrate për ndërtimin e rrjeteve frekuencore.

Sigurisht që ka një dorë, e cila do që Televizioni Publik të mos jetë televizion publik. Dora e parë është politika, se do ta kontrollojë, dora e dytë është pjesa e konkurrencës dhe ne e dimë shumë mirë, prandaj kjo punë u degradua që në rrjetet frekuencore, se ishin tri që i kishte Radiotelevizioni Publik dhe ai duhej t’i administronte. Mbivendosja e kanaleve në rrjetet frekuencore do t’i sillte të ardhura RTSH-së, ndërsa ju sot vini të raportoni për gjithë këtë investim, i cili qenka humbje.

Sot unë po e marr vesh, pas kaq vitesh, që investimi është kot, është i humbur, sepse nuk i nxjerr të ardhurat e tij. Kemi bërë debat edhe për çmimin që duhej të paguanin televizionet lokale në rrjetet frekuencore, kemi bërë disa mbledhje rresht, dhe situata është keqmenaxhuar

në mënyrën më skandaloze. Dhe këtu, jo për afinitet politik, unë mbështes idenë që burimi i së keqes është statuti i RTSH-së. E kemi atakuar këtu, sepse çdo e keqe erdhi nga mënyra si u zgjedh drejtori i RTSH-së. Është bërë debat këtu dhe është ndryshuar statuti i RTSH-së për të zgjedhur Gëllçin. E bënë gjoja si Presidenti i Republikës, se erdhi maxhoranca atëherë me shumicë votash dhe çfarë prodhoi?! Korrupsion dhe humbje të besimit të RTSH-së. Në qoftë se ka qenë shikueshmëria 10%, as 10% nuk është tani, megjithëse kanalet janë shtuar. Mendoj se duhet parë ligji i medias, sepse kushtëzon në rastin e pasjes së rrjetit frekuencor, duhet të kesh kanale për këtë apo për atë, por është tmerr kur nuk ke kanal për fëmijë, kur nuk ke kanal artistik, që i ke të detyruara me ligj, si dhe do të vendosësh patjetër një “Agro”, duhet edhe “Agroja”, nuk diskutohet fare!

Pra, të gjitha këto burojnë nga mënyra se si është bërë politika, si është menaxhuar RTSH-ja, si është hartuar statuti dhe në mënyrën se si sot operon RTSH-ja unë shoh se ka një konflikt midis Këshillit Drejtues të RTSH-së, Bordit të Administrimit dhe drejtimit të RTSH-së. Kompetencat nuk janë të qarta, nuk ka përputhje dhe harmoni në vendimmarrjen e institucionit tuaj dhe më vjen keq që përballem gjithmonë me zëvendësdrejtorin që bën detyrat e drejtorit; na ka ndodhur edhe herë tjetër. Ky është një boshllëk ligjor, i cili duhet shëruar në mënyrë urgjente, por shërimi vjen përsëri nga ajo që e ka shkaktuar, nga politika.

Ne e kemi bërë kërkesën nëpërmjet zotit Gjekmarkaj që duhet të riformatohet Këshilli Drejtues në mënyrë urgjente dhe ju duhet ta pranoni një gjë të tillë. Ne kërkojmë që përfaqësuesit të jenë të mbështetur, të mos jenë njerëz politikë, sepse depolitizimi është i përcaktuar në ligjin e medias të vitit 2013, por të jenë të mbështetur, sepse opoenca politike e njerëzve që kanë zë, që duan që gjërat të bëhen drejt, do të krijonte një ambient shumë të mirë për ecjen përpara të RTSH-së.

Unë e shoh gjendjen e RTSH-së si në seancën e parë ku kam marrë pjesë, në atë gjendje që diskutonim edhe ligjin. Pra, nuk ka ecur fare, vetëm është investuar, ka thithur lekë, ka bërë këtë korrupsion galopant dhe sot gjendemi në pikën zero, aq sa zoti Bungo thotë “ta mbyllim 6 muaj”.

E kam dëgjuar këtë ide në fillim, kur Rama mori pushtetin dhe donte t’i vinte çelësin RTSH-së. Kjo është një ide që nuk me ngjit, të them të drejtën. Kjo do të pasohej nga një parullë “na falni për propagandën”, por u bind sepse u bënë debate në komision, që duhej mbështetur. Kërkesa e marrëveshjes së Gjenevës në vitin 2005 kushtëzonte kalimin në rrjetet frekuencore digjitale dhe u bë një transformim digjital, por rezultoi se ka produkt, sa një investim analog.

Unë mendoja se Televizioni Publik do të dominonte, me tri rrjete frekuencore dhe me gjithçka, por lobimet dhe politika bënë që sot të jemi në këtë gjendje. Dikush mbyll një sy, dikush toleron dhe në fund fare kemi korrupsion, burgosje, rënie të reputacionit dhe asgjë tjetër.

A kemi ne këtu përgjegjësi? Po, kemi të gjithë bashkë, edhe ne, edhe ju, prandaj thashë që buxheti është momenti i politikave. Çfarë politikash duhen dhe çfarë mbështetjeje kërkoni nga ne? Nuk është mbështetje thjesht e kërkesës që duan 100 milionë lekë për arkivin.

Zoti Leka, bëre një paralelizëm që nuk më pëlqeu: “Po ta kisha privat...”. Ti je administrator. Zëre se je privati, se je ti ai që administron dhe do t’i gjeje 100 milionë lekë me forcat që ka RTSH-ja, që ne i dimë pak a shumë.

Unë do të doja që Televizioni të mos kërkonte para për mirëmbajtjen. Televizioni është ent publik që ka edhe sensin e biznesit. Rrjeti frekuencor është biznes. Mirëmbajtjen e keni ju, se ju merrni të ardhura. Rishikoni të ardhurat dhe në qoftë se të ardhurat për rrjetet frekuencore janë të papërballueshme për mirëmbajtjen, rrisni tarifën, por në bashkëpunim me televizionet lokale, se ka marrëveshje kjo punë, nuk bëhet kështu.

Pra, që të jemi të qartë, nuk mund të vijë RTSH-ja këtu, me një tabelë me disa zëra, dhe u krye. Cilat janë politikat? Cilat janë prioritetet tuaja për t’i shpenzuar me efikasitet paratë që ju janë dedikuar dhe paratë që kërkoni? Prioritet është hapja e një kanali për fëmijë. Sa lekë duhen? Dakord dhe ne do ta kërkonim bashkë, se duhet një kanal për fëmijë. Programet artistike që kanë qenë të shkëlqyera në momente të caktuara, në momente pikante, pse të mos bëhen? Jo kanale që nuk i sheh kush, emisione që nuk kanë audiencë apo për gjëra të tjera. Edhe kjo puna e gazetarëve, se televizioni ka edhe gazetarë, bën edhe kontrata projektsh me gazetarë të tjerë. Unë nuk e kam kuptuar këtë, me ju thënë të drejtën, se është kalim parash për të gjetur mënyrën se si t’i shpenzoni.

Pra, unë desha nga ju prioritetet. Ndoshta u zgjata, por ky ishte thelbi.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Boçi!

Shoh se ka nevojë për një rishikim kompleks të situatës, që lidhet me ligjin për medien, që me statutin e RTSH-së, me Këshillin, me drejtimin, administrimin, strukturën, programacionin etj., që do të thotë se edhe ne si politikë, të dy krahët e politikës, kemi nevojë të investohemi në këto çështje në mbledhje më të organizuara me këtë qëllim.

Sot jemi te buxheti dhe ne e kemi të pamundur ta kapërcejmë këtë moment, pra jemi të detyruar të shohim situatën, strukturën dhe sasinë e buxhetit që ju jepet, gjithmonë me dashamirësinë për t’i përmirësuar gjërat.

Nëse ne, të dyja palët, do ta shohim të logjikshme që të mund të investohemi dhe të kërkojmë diçka më tepër, sigurisht do ta bëjmë këtë gjë.

Mendoj se të gjithë kemi ato pikëpyetjet tona, pra jemi pak të frenuar për t'iu përgjigjur pozitivisht kërkesës suaj, sepse duket që synimi dhe përmbajtja e diskutimeve tona është përgjithësisht te miradministrimi i kësaj që është dhënë dhe jepet edhe në projektbuxhetin e deritanishëm.

Urdhëroni, zoti Madhi!

Pandi Madhi – Faleminderit!

Kjo është një shkresë e Ministrisë së Financave dhe kolegu është këtu. Për vitin 2021 është 606 milionë pjesa e fondeve buxhetore në dispozicion të RTSH-së. Shifra 618 milionë është për vitin 2022.

Në fazën e dytë të projektbuxhetit nuk bëhen kërkesa shtesë afatmesme dhe e vetmja mundësi që të paraqesim kërkesë shtesë është këtu te ju.

Petro Koçi – Urdhëroni, Desantila!

Desantila Tahiraj – Pyetja ime është që në gjithë këtë buxhet që ju kërkon, sa parashikoni të jenë shpenzimet direkte dhe sa shpenzimet indirekte në përqindje?

Pandi Madhi – Unë ju bëra një paraqitje të shpenzimeve të RTSH-së, pra 40% e zënë pagat, që janë shpenzime direkte, po kështu edhe shpenzime të tjera që lidhen me mirëmbajtjen që zënë 12-13% të buxhetit. Po kështu, pagesat ndaj institucioneve ndërkombëtare zënë 6% të buxhetit. Pra, shumica janë shpenzime, të cilat janë të përcaktuara. Pagesat e energjisë elektrike dhe ujit, janë edhe këto.

(Diskutime në sallë.)

316 milionë nga 2 miliardë e 445 milionë për vitin 2021. Buxheti i RTSH-së ka këtë karakteristikë që në investime dhe në projekte parashikohen aq fonde sa mbeten, se të ardhurat janë ato që janë, edhe këto nuk po realizohen, për arsye se 60% e të ardhurave është tarifa e shërbimit për përdorimin e aparatit televiziv, pjesa juaj e financimit buxhetor zë 25%, ndërsa pjesa tjetër janë të ardhurat.

Është e vërtetë ajo që tha zoti Boçi se për shkaqe të krijimit të disa rrjeteve, të ardhurat që mund të merrte RTSH-ja nga operatorë të tjerë, parashikohet që të ulen, se çdo periudhë ikin operatorë privatë nga shërbimi që ofron RTSH-ja për përhapjen e tyre. Është konkurrencë, shkojnë në një rrjet tjetër që është më lirë.

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Madhi!

Është e qartë që, në parim, një televizion më i parë, më i suksesshëm do të gjenerojë të ardhura shumë më tepër dhe ju duhet të kini më shumë buxhet edhe për ato drejtime që interesohet deputetja.

Urdhëroni, zonja Bano!

Eralda Bano – Faleminderit, zoti Koçi!

Në fillim dua të bëj një falënderim, mirënjohje dhe respekt për zotin Bungo, për të gjitha kontributet që ke dhënë për artin dhe kulturën në vendin tonë.

Në fakt, nëse duhet të gjesh modelin e një institucioni të vjedhur, të sakatuar të këtij shteti të përdorur nga çdo pushtetar, është RTSH-ja.

Po hyj direkt në pyetje për mos t’ju marrë shumë kohë.

Pyetje për zotin Martin Lekaj:

1. Kur e ka matur audiencën për herë të fundit RTSH-ja?
2. Cilat programe rezultojnë me audiencën më të mirë të publikut, ato me projekte apo prodhimi i stafeve të RTSH-së?
3. Ju si administrator, përgjegjës, zëvendës drejtor jeni anatemuar nga mediet për veprime korruptive dhe amorale. A ndiheni personalisht i sulmuar? Raportet e auditit të brendshëm për RTSH-në të Këshillit apo KLSH-së a kanë gjetur shkelje?
4. A keni pasur konflikt interesi në përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Ankesave apo emërimin e punonjësve?

Faleminderit!

Petro Koçi – Urdhëroni, zoti Leka!

Është në tagrin tuaj të vendosni nëse do t’u përgjigjeni pyetjeve që janë jashtë buxhetit.

Martin Leka – Për audiencën e fundit është bërë në një bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe, për hir të së vërtetës, ju mund të bisedoni me Departamentin e Gazetarisë për një sondazh supershkencor të matjes së audiencës së RTSH-së. Janë përdorur 3 mijë kampionë, nga ku del audiencia e RTSH-së. Pasqyrën nuk e kam.

(Diskutime në sallë.)

E dyta, për sa u përket akuzave, nuk po e përmend emrin e portalit. Në qoftë se ju i referoheni një portali që mund ta quaj “terrorist”...

(Diskutime në sallë.)

Eralda Bano – ...vetë punonjësit tuaj brenda Radiotelevizionit Shqiptar. Analizën e saktë e bëri dhe zoti Bungo tani, në këtë rast, më mirë se kushdo tjetër.

Martin Leka – Për...?

Eralda Bano – Për një korrupsion galopant ndër vite të Radiotelevizionit Shqiptar.

Martin Leka – Tani, për korrupsionin ka organe kompetente. Kush është i aftë, të bëjë denoncimin. Unë dërgoj në shtëpi vetëm rrogën time. Megjithatë, kjo është përgjegjësi e kujtdo. Është i hapur kushdo, edhe unë jam i hapur ndaj kujtdo, të bëjë çdo lloj denoncimi, jo akuzë, në lidhje me korrupsionin e bërë nga personi Martin Leka që ditën e parë kur ka filluar punë, në vitin x e deri sot. Nuk ka problem.

Për të tjerat, më vjen keq që përmendni akuza që kanë lidhje... Unë e di, këtu të bëjnë me 700 të dashura e të tjera. Këto janë portale terroriste dhe Komisioni i Medias, para se të bëjë këtë për Radiotelevizionin Shqiptar, duhet të bëjë një ligj për këto portalet terroriste, që terrorizojnë dhe kalamajtë në shtëpi, duke u çuar baballarëve dashnoret në shtratin e gruas.

Petro Koçi – Kalojmë te përgjigjja tjetër. Të mos e personalizojmë kot tani.

Martin Leka – Kjo është ajo që dua të them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petro Koçi – Sa më shkurt, të lutem!

Blerina Gjyklameti – Shumë shkurt. Nuk është as në nderin, as në respektin, as në përgjegjësinë e këtij komisioni të përcjellim gjithë llumin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta përfundoj, se nuk ju ndërhyra.

...që gjejmë nëpër portale në këtë tryezë. Unë besoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, mos më ndërhyri! Unë nuk ju ndërhyra.

Në nderin dhe në përgjegjësinë e këtij komisioni nuk është të themi sa herë na vjen dikush për të folur për rendin e ditës: “Shyqyr që na erdhi përballë, të bëjmë dhe pyetje të tjera”. Absolutisht jo! Ne kemi mundësinë, kemi detyrën që me kërkesa t’u drejtohem institucioneve përgjegjëse, t’i thërrasim në dëgjese për çështje që na shqetësojnë dhe seancën për buxhetin të mos e kthejmë në çfarëdo që dëgjojmë lart e poshtë e t’i sjellim në tryezën e këtij komisioni.

Nga ana tjetër, kemi diskutuar disa herë së bashku për çështje që u interesojnë disa kolegëve, por edhe të gjithë komisionit, për të bërë dëgjesa. Sikundër po ndodh në komisionet e tjera, ku jemi duke organizuar dëgjesa me institucionet që raportojnë pranë komisioneve përgjegjëse, mund të ndodhë dhe në këtë komision. Kërkesat përkatëse t’ua drejtojmë institucioneve dhe pasi të përfundojmë buxhetin, t’i thërrasim, sepse janë çështje me interes publik, përtej interesit tonë personal.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit!

Mendoj se...

Leka Bungo – Më falni, a mund të më jepni një minutë kohë për diçka?

Petro Koçi – Po ju toleroj, si miq të vjetër që jemi.

Leka Bungo – Unë do t'i propozoja Komisionit të Medias të marrë në konsideratë seriozisht kërkesën për të riparë ligjin për median, statutin e Radiotelevizionit Shqiptar, sepse që atje fillon e keqja.

Petro Koçi – Dakord.

Ju faleminderit!

Leka Bungo – Nuk e kam mbaruar 1-minutëshin. Kam folur 30 sekonda.

E dyta, mendoj se atje është bërë një përmbysje në këta 6 muaj, se ka pasur një keqkuptim të tmerrshëm, që Këshilli Drejtues ka qenë vartës i drejtorit të Përgjithshëm. Kjo është çudi e madhe! Tani kanë ndryshuar raportet. Nuk është më kështu. Tani është Këshilli Drejtues mbi drejtorinë e Përgjithshme dhe kështu do të vazhdojë.

Megjithatë, po ju them sinqerisht se ndërhyrja juaj, e komisionit, është vendimtare për t'i zgjidhur këto probleme, që kanë të bëjnë me legjislacionin, jo me kërkesat personale. Unë e di, atje jam thjesht Haxhi Lleshi, por ama ai tjetri duhet të jetë atje, sipër atij tjetrit. Kjo është historia.

Petro Koçi – Faleminderit!

Besoj se edhe unë e konsiderova këtë gjë, kur thashë që nga diskutimet e të gjithë deputetëve, të të gjitha palëve, u duk qartë që ka një nevojë për të rishikuar në thelb të gjithë situatën, që lidhet me ligjin për median, me statutin e Radiotelevizionit, strukturën, drejtimin, organikën e shumë gjëra të tjera, me raportet ndërmjet institucioneve, këshillit dhe, po themi, ekzekutivit të Radiotelevizionit.

Ne jemi të hapur që çdo ide, pavarësisht nga cila palë vjen, në kuptimin e palëve politike apo nga ju, që jeni më të përfshirë në përditshmërinë tuaj në çështjet e Radiotelevizionit, ta shqyrtojmë me kujdes, me racionalitet, ndoshta duke përfshirë edhe idetë radikale, që, sigurisht, kërkojnë një gjakftohtësi dhe një gjykim shumë të pjekur.

Faleminderit për prezencën!

Të na falni për ndonjë mëkat politik në retorikën tonë! Mbledhja me ju ishte kënaqësi!

Faleminderit!

2 minuta pushim, sa të fillojmë seancën tjetër.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2021, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Seancë dëgjimore me drejtoren e Përgjithshme të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, zonjën Valbona Zhupa, për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022” .

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Flutura Açka, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Kastriot Piroli, Merita Bakiu dhe Luçiano Boçi.

Mungojnë:

Agron Gjekmarkaj dhe Meri Markiçi.

Të ftuar:

Valbona Zhupa - drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Telegrafike Shqiptare,
Romelda Rrapollari - drejtore e Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë Telegrafike Shqiptare,

Gentian Opre - drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Petro Koçi – Përshëndetje edhe një herë!

Fillojmë seancën e dytë të mbledhjes së sotme, në përputhje me rendin e ditës.

Kemi një seancë dëgjimore me drejtoreshën e Përgjithshme të ATSH-së, zonjën Valbona Zhupa, për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022” .

Janë të ftuar zonja Valbona Zhupa, drejtoreshë e Përgjithshme e ATSH-së dhe zonja Romelda Rrapollari, drejtoreshë e Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në ATSH. Sigurisht, i pranishëm është dhe zoti Gentian Opre, drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Sipas mënyrës si operojmë, fillimisht jeni ju që duhet të na paraqisni një pasqyrë për projektbuxhetin e deritanishëm për agjencinë tuaj. Më pas ka pyetje, diskutime apo komente nga anëtarët e komisionit.

Zonja Zhupa, fjala për ju.

Valbona Zhupa – Mirëdita!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Unë jam Valbona Zhupa.

Po filloj direkt me paraqitjen e projektbuxhetit për Agjencinë Telegrafike Shqiptare për vitin 2022.

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Duke ju përshëndetur dhe falënderuar për komunikimin, po ju përcjell disa mendime për projektbuxhetin e vitit 2022 për Agjencinë Telegrafike Shqiptare!

Agjencia Telegrafike Shqiptare, si një institucion klasik dhe unik i medias publike në Shqipëri, qëllim të politikës së saj ka vërtetësinë e lajmit, të konfirmuar nga burime autentike dhe zyrtare, pa asnjë koment dhe deformim, pra sipas parimit të saktësisë dhe paanësisë.

Pjesa më e rëndësishme e lajmeve nga vendi përkthehen në dy gjuhë të huaja, përkatësisht në anglisht dhe frëngjisht, gjë që përbën një aset të rëndësishëm për të informuar opinionin publik ndërkombëtar për zhvillimet në Shqipëri. Duke ndjekur modelin e shumë agjencive të rëndësishme botërore, ne synojmë që nëpërmjet lajmeve të jemi kontribues, duke informuar për ligjet, aktet e rëndësishme për çështjen e investimeve, tregun shqiptar të kapitaleve dhe resurset turistike që paraqet vendi ynë.

Ndërkaq, ATSH-ja transmeton lajme nga bota apo rajoni, të marra nga agjencitë partnere, me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi, si: agjencia prestigjioze gjermane DPA, agjencia francezë AFP, agjencia italiane ANSA apo agjenci të njohura rajonale si ajo turke Anadolu Agency, agjencia greke ANA-MPA, agjencia bullgare BTA, agjencia rumune Agropress e të tjera.

Vizioni që kemi për ta modernizuar këtë institucion është një ndërmarrje jo e lehtë, për shkak të *website*-eve që shtohen çdo ditë dhe piraterisë.

Lajmet tona i shohim kudo ku klikojmë. Rreth 70% e lajmeve të ATSH-së merren rregullisht nga gazetatat dhe portalet e ndryshme në mënyrë pirate, duke u hequr logon dhe duke i shfrytëzuar si lajme të tyre, gjë që përbën një handicap të madh për ne.

Ne synojmë kështu ta kthejmë Agjencinë Telegrafike Shqiptare në një agjenci lajmesh publike, por duke iu përgjigjur edhe kërkesave që ofron sot tregu dhe teknologjia, që avancojnë çdo ditë.

Në faqen tonë të internetit operojmë edhe me shërbimin e lajmeve video të ATSH-së, duke e bërë atë më të lehtë në përdorim, por edhe më gjithëpërfshirëse e tërheqëse për lexuesin, duke ofruar informim sipas standardeve më të fundit. Programi buxhetor i ATSH-së është hartuar nga ana jonë në mënyrë të tillë që të realizojë objektivat e programit të qeverisë. Kjo PBA mbulon financimin e shpenzimeve për paga për punonjësit, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime për investime. Ky program buxhetor afatmesëm është përgatitur duke u bazuar në udhëzimin nr.8, datë 26.2.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024” dhe VKM-në nr.190, datë 3.3.2021 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”.

Për vitin 2022, fondi i akorduar për këtë program, pra për veprimtarinë informative të ATSH-së (kodi 08320), është parashikuar të jetë 59,2 milionë lekë; fondi i pagave (zëri 600) 37,2 milionë lekë; fondi i sigurimeve shoqërore (zëri 601) 6,45 milionë lekë; fondi për shpenzime operative (zëri 602) 11,5 milionë lekë; fondi për transfertat me jashtë (zëri 605) 3,5 milionë lekë dhe fondi për investimet e trupëzuara (zëri 231) 1 milion lekë. Pra, totali është 59,2 milionë.

Në zërin 600 “Paga për punonjësit”, fondi i planifikuar mbulon detyrimet për pagat, për sa kohë parashikohet të mos ketë ndryshime në organikë, po ashtu edhe fondi i parashikuar për zërin 601 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore”. Theksojmë se ky fond është zvogëluar, për shkak të largimit nga struktura jonë organike të Drejtorisë së Informimit dhe Monitorimit, e përbërë nga 10 nëpunës.

Në zërin 602 janë mallrat dhe shërbimet. Planifikimi për shpenzime është bërë duke parashikuar të kryhen shpenzime për të përballuar mbulimin e nevojave administrative, si: energji, telefona, shërbim sigurie, karburant, udhëtime, dieta brenda dhe jashtë vendit, në funksion të veprimtarisë informuese të ATSH-së, duke u fokusuar në intensifikimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët në rajon dhe vendet e tjera të botës, si dhe kryerja e blerjeve dhe prokurimeve të mallrave dhe shërbimeve për nevojat e ATSH-së, si: kancelari, dezinfektim i ambienteve, riparime dhe mirëmbajtje zyrash, mirëmbajtje e riparim automjetesh e të tjera.

Në zërin 605 janë transfertat me jashtë. ATSH-ja transmeton lajmet nga bota apo të marra nga agjencitë partnere, me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi. Me fondin prej 3,5 milionë lekësh në vit parashikohen të mbulohen detyrimet ndaj agjencive të huaja për shërbimin e lajmit dhe kuotat e anëtarësimit.

Në zërin 231, ku janë shpenzimet për investime, dua të ndalem pak, sepse ky është një drejtim i rëndësishëm i punës sonë dhe flitet për digjitalizimin e arkivit të ATSH-së. Ne kemi një arkiv prej 250 mijë fotosh, negativësh dhe buletinesh. Për këtë arsye, të gjithë e dimë sa i rëndësishëm është arkivi. Ai arkiv është një memorie vizive dhe historike e Shqipërisë, jo vetëm i ATSH-së. Ka nisur një proces digjitalizimi në dhjetor të vitit 2020, pasi u shty si pasojë e tërmetit dhe pandemisë dhe nuk u realizua në kohën e duhur. Ky projekt kalon në disa faza, ka disa procese dhe është shumë delikat.

Ne kemi një fond prej 1 milion lekësh çdo vit, pra për vitet 2022, 2023, 2024, por ky fond është i pamjaftueshëm për të realizuar këtë projekt, sepse, siç e dimë, digjitalizimi është objekt edhe i qeverisë, i bërë publik. Ndaj kërkojmë nga ky komision një fond shtesë prej 5 milionë lekësh.

Do t'ju isha shumë mirënjohëse nëse do ta konsideronit këtë, sepse arkivi i ATSH-së është shumë i rëndësishëm dhe aktualisht është në gjendje shumë të keqe. Duke qenë të ndërgjegjshëm për mundësitë financiare, do të kërkonim që hap pas hapi të ndërronim tërësisht teknologjinë dhe procesi të vijojë me buxhetet pasardhëse.

Duke besuar në mbështetjen që na jep ky komision, ju uroj punë të mbarë!

Faleminderit për vëmendjen!

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Zhupa!

Kalojmë te pyetjet nga anëtarët e komisionit.

Po, zonja Aça.

Flutura Aça – Zonja Zhupa, faleminderit për panoramën!

Në fakt, unë e kam lexuar edhe më parë materialin.

Kam vetëm dy gjëra të vogla, që mund t'ju quani dhe si tërheqje vëmendjeje, sigurisht, jo e qëllimë.

Ju flisni për *copyright*-in dhe e dini shumë mirë që jeni ent i pavarur, ent shtetëror dhe keni gjithë fuqinë dhe gjithë mbështetjen e institucioneve që mund t'ju mbrojnë në këtë gjë. Ju e kuptoni që arkiva juaj është shumë e rëndësishme dhe keni të drejtë të gjeneroni të ardhura edhe pas 10 apo 100 vjetësh. Kështu që kur e keni ju këtë problem, mendojeni se çfarë ndodh me të tjerët. Kjo ishte në relacionin tuaj. Ju më shumë e shprehni si shqetësim, e kuptoj, por kjo nuk ka lidhje drejtpërdrejt me buxhetin. Apo ka ndonjë lidhje me buxhetin dhe ne duhet ta fiksojmë edhe këtë, që ju keni nevojë për ndihmë me një fond shtesë edhe për çështjen e *copyright*-it? Doja të dija se përse kjo duhet të ishte në këtë relacion, megjithëse e di që është një shqetësim shumë i madh.

Ndërmjet të tjerave ju thatë që programi buxhetor i ATSH-së është hartuar dhe nga ana jonë, në mënyrë të tillë që të realizojmë objektivat e programit të qeverisë. Në relacionin tuaj ju e përmendët tri herë qeverinë. Nuk e di nëse ju e dini që jeni një institucion i pavarur dhe vareni vetëm nga parlamenti i Shqipërisë. Mund të keni dhe objektiva që lidhen edhe me qeverinë, por nuk mund ta sillni qeverinë si një *stopword* këtu, se ju jeni një institucion i pavarur dhe vareni vetëm nga parlamenti i Shqipërisë. Këtë jua bëj si një vërejtje shumë miqësore në punën tuaj, sepse nuk jeni kasnecë të qeverisë, as të opozitës dhe të ndokujt tjetër. Ju thjesht jeni njerëz që duhet ta përcillni mirë lajmin, të drejtë dhe të pavarur.

Ndërmjet të tjerave thatë që digjitalizimi u shty për shkak të pandemisë dhe tërmetit. Për pandeminë e kuptoj, por nuk e kuptoj se çfarë lidhjeje ka tërmeti me punën tuaj. Kjo m'ua duk pak e çuditshme. Jua bëra vetëm si vërejtje. Kaq kisha.

Për sa i takon fondit shtesë, kur bëhet fjalë për të ruajtur arkivin e këtij kombi, do të miratoja çdo lloj shtese buxheti, sepse ka të bëjë me një gjë shumë të rëndësishme.

Faleminderit!

Petro Koçi – Shumë faleminderit, zonja Aça!

Po, zonja Zhupa.

Valbona Zhupa- Shumë faleminderit për pyetjet!

Doja vetëm t'ju bëja me dije se, kur flas për *copyright*-in, e kam fjalën për lajmet. Nuk kemi asnjë shqetësim për *copyright*-in për fotot, sepse, meqë po flasim këtu, ne jemi në një proces inventarizimi të fotove, pra akoma nuk është bërë ky proces; nuk dimë sa negativë, sa filma dhe sa buletine kemi. Kjo është gjëja më kryesore. Ne paralelisht donim të vazhdonim me digjitalizimin, që është pjesa më e pastër aty, që nuk ka nevojë për asnjë ndërhyrje dhe është

ajo që kërkojnë më shumë njerëzit. Në kërkesat që na vijnë kërkojnë vetëm fotot karshi buletineve. Nuk është çështja te *copyright*-i i fotove, se ato janë shumë në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sa i përket çështjes së pandemisë dhe tërmetit, dua thjesht të them që kam vetëm 4 muaj në këtë post dhe mendoj se nuk janë miratuar buxhetet shtesë, siç po kërkoj unë sot, nga komisionet në vitet e kaluara. Prandaj aty është vënë në kllapa, që është shtyrë, si të kërkonim sot për shembull, 5 milionë lekë, por do të thoshin: nuk kemi lekë, sepse kemi pandeminë dhe tërmetin, ndaj është vënë një “justifikim” pse nuk ka filluar më parë ky proces. Normalisht, duhet të kishte filluar.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja Zhupa!

Zonja Zake dhe më pas zoti Spaho.

Enslemvera Zake – Faleminderit!

E falënderoj drejtoreshën për prezantimin dhe për relacionin!

Unë kam një pyetje: Ju kërkon vetëm shtesë për investime në procesin e digjitalizimit, pra nga vlera 1 milion lekë, të parashikuara për vitin 2022, në vlerën 5 milionë për vitin 2022. A mund të na sillni një analizë të thelluar se çfarë zërash përfshihen në këtë vlerë të konsiderueshme prej 5 milionë lekësh shtesë, që ju nevojiten për procesin e digjitalizimit? Pra, zërat që përfshijnë preventivin, që parashikojnë shpenzimet prej 5 milionë lekësh për vitin 2022.

Petro Koçi – Faleminderit!

Mund të përgjigjeni!

Romelda Rrapollari – Jam Romelda, drejtoreshë e Financave dhe Burimeve Njerëzore në Agjencinë Telegrafike Shqiptare.

Për sa i përket pyetjes suaj, do të doja t’ju sqaroja se ne kemi një projekt të përbashkët me AKSHI-n, të cilët kanë marrë përsipër të kryejnë studimin e tregut, që është faza fillestare, dhe për këtë kemi ngritur një grup pune të përbashkët me punonjës të AKSHI-t dhe Agjencisë Telegrafike Shqiptare, të cilët po punojnë për të nxjerrë studimin e tregut, çka përmban edhe efektet financiare të këtij projekti, por, në të gjitha takimet e grupeve të punës me AKSHI-n, duke qenë se ne jemi të paafte ta vlerësojmë vlerën financiare të projektit, kemi rënë dakord që kjo vlerë të shtrihet në disa vite, dhe meqenëse është më e madhe se 5 milionë lekë të rinj, që po i kërkojmë shtesë, nënkupton se ne kërkojmë një mbështetje në vite. Pra, kjo mund të kërkojë minimalisht edhe 3-4 vjet, në mënyrë që të përfundojë. Vlera që ne kërkojmë sot është e pallogaritshme në raport me atë që duhet për t’u përfunduar projekti.

Petro Koçi – Faleminderit!

Zoti Spaho.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, mund të flisni.

Enslemvera Zake – Faleminderit!

Doja të thosha se nuk kemi kundërshtime për shpenzimet e investimeve, por duam të dimë çfarë përfshihet në vlerën prej 5 milionë lekësh? Cilët janë zërat që përfshihen në vlerën 5 milionë, që ju nevojiten për vitin 2022, dhe pse nuk janë 3 apo 7 milionë?

Petro Koçi – Besoj se pyetja është e qartë.

Pse duhen 5 milionë për këtë vit?

Romelda Rrapollari – Duke qenë një megaprojekt digjitalizimi për arkivin e ATSH-së, kemi menduar të fillojmë vetëm me një pjesë të buletineve, që përfshijnë buletinët nga faza fillestare në vitet '42-'43 deri në vitet '92-'93. Kjo përfshin një numër buletinesh, rreth 192, por dua t'ju them se totali i buletineve është përafërsisht rreth 4 mijë. Normalisht, kjo nënkupton se ky projekt është shumë herë më i madh sesa vlera që ne kërkojmë.

Kërkesa juaj është shumë e drejtë, por duke qenë se jemi në realizimin e fazës së parë të projektit, ne presim studimin e tregut nga AKSHI dhe përcaktimin e vlerave me zëra. Në këto momente do të kemi një tablo të qartë se çfarë përmban faza e parë, por dua t'ju them se është rënë dakord që ky megaprojekt është 3-4 fishi i vlerës që ne kërkojmë sot. Domethënë, deri në këto momente, kaq kemi të qartë për të përcaktuar.

Petro Koçi – Faleminderit!

Zoti Spaho, ju lutem!

Florenc Spaho - Faleminderit, kryetar!

Zonja Valbona, ju përgëzoj për detyrën tuaj!

Ju kam ndjekur këto 4 muaj për ato që keni bërë dhe për ndryshimin e qasjes për këtë agjenci. Kjo është një agjenci shumë e rëndësishme. Pyetja ime do të ishte mbështetje, bashkë me koleget Ačka dhe Zake. Ne jemi absolutisht dakord për miratimin e buxhetit dhe duhet të ishte edhe pak më tepër. Relacioni që ju paraqitët ishte mjaft shterues, por mungon diçka. A nuk keni ju nevojë të ruani nga *copyright* apo diçka tjetër, ose për të qenë më promovues të lajmeve që ju bëni? A keni nevojë për staf shtesë dhe specialistë të mirëfilltë të fushës përkatëse?

Faleminderit!

Valbona Zhupa – Për momentin ne jemi 40 veta dhe mendoj se misioni kryesor i Agjencisë është vërtetësia dhe paanshmëria e lajmit. Deri tani nuk besoj se ka.

Ndër vite, edhe më parë, edhe tani që jam unë, mendoj se Agjencia Telegrafike Shqiptare e ka kryer me sukses këtë mision, sepse aty punohet me vetëmohim, pagat janë mëse normale dhe vetëmohimi është thelbi i kësaj agjencie.

Ndërkohë, ne do të flasim edhe me AMA-n për pjesën e *copyright*-it, sepse ai institucion merret. Mund të bëjmë një marrëveshje, mund të bëjmë një memorandum bashkëpunimi, jo vetëm ne, por edhe të tjerë, që vuajnë nga kjo. Ky problem nuk është vetëm yni, por jam e sigurt që sot një lajm në një portal është *copy paste* në 100 portale, qoftë i vërtetë apo i rremë. Këtë luftë duhet ta bëjmë të gjithë nga pak, sidomos ne që jemi të fushës.

Petro Koçi – Faleminderit!

Besoj se me AMA-n e keni më të lehtë bashkëpunimin se me çdo institucion tjetër.

Zonja Gjylameti.

Valbona Zhupa – Doja të shtoja diçka të fundit në respekt të zonjës Açka dhe pyetjes që bëri për përmendjen e qeverisë në materialin relatues që kemi paraqitur. Ne jemi një institucion buxhetor dhe në këtë kontekst është përmendur edhe qeveria në këtë shkresë.

Petro Koçi – Në pikëpamje të buxhetit.

Zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zonja Zhupa, për prezantimin dhe kërkesat, që ishin jo vetëm realiste, por edhe të mbështetura në objektin e punës suaj!

Në vijim të pyetjeve dhe të sugjerimeve të zonjës Açka, do të vijojë me pjesën e të ardhurave dytësore që krijon institucioni juaj. Sa janë ato në krahasim me të ardhurat apo mbështetjen nga buxheti i shtetit?

Zonja Açka ju tha nëse keni mundësi të krijoni të ardhura dytësore, sa janë ato? Unë dua të di sa është totali i të ardhurave dytësore në raport me mbështetjen buxhetore?

Faleminderit!

Petro Koçi – Shumë e drejtë.

Përgjigjuni, ju lutem!

Romelda Rrapollari – Ne jemi institucion 100% buxhetor, por kemi të drejtë të kryejmë shitje të fotove të arkivit të Agjencisë Telegrafike Shqiptare, që shiten me shuma gati qesharake për rëndësinë dhe vlerat që kanë. Ne kemi kërkuar disa herë të rishihen tarifat e shitjeve të fotove të arkivës, por momentalisht po vazhdojmë me të njëjtat tarifa që nga viti 1992.

Në vijim të ...

Blerina Gjylameti – Cili institucion i miraton tarifat e shërbimeve që ju ofroni?

Romelda Rrapollari – Këto janë rënë dakord me një ...

Petro Koçi – Pyetja ishte se cili institucion përcakton tarifat.

Romelda Rrapollari – Tarifat janë rënë dakord me një propozim që Agjencia Telegrafike rreth viteve 1990 i ka bërë Ministrisë së Financave dhe ata kanë akorduar disa çmime të përcaktuara në gjykimin e tyre në ato vite.

Petro Koçi – Faleminderit!

Ministria e Financave është prezente.

Ju lutem, regjistroni, sepse kjo gjë është shumë e rëndësishme!

Romelda Rrapollari – Kjo duhet riparë.

Petro Koçi – Ne duhet të ecim në përputhje me zhvillimet dhe standardet e tregut të sotëm, jo të vitit 1992.

Romelda Rrapollari – Në vijim të pyetjes, do të doja të thosha se ne nuk përfitojmë asgjë nga vlerat e shitjeve të fotove të arkivës, sepse këto rialokohen në buxhetin e shtetit. Pra, konsiderohet sikur këto rivijnë në buxhetin tonë pasardhës.

Petro Koçi – Kjo nuk ka rëndësi, por me këto standarde është humbje për buxhetin.

Romelda Rrapollari – E vërtetë.

Petro Koçi – Aq sa është, le të jetë e vogël, por nëse çmimi është i standardit të vitit 1992, imagjinoni çfarë ndryshmi ka tregu. Kjo është humbje.

Romelda Rrapollari – Doja të thosha edhe që në kushtet ku jemi, kjo ul edhe të ardhurat tona, pasi, duke mos e kryer procesin e digjitalizimit, e kemi shumë herë më të vështirë, sepse të gjithë klientët që vijnë kanë një kohë të përcaktuar për të tërhequr fotot.

Petro Koçi – E kuptuam këtë, drejtoreshë.

Romelda Rrapollari – Doja të theksoja se duke bërë digjitalizimin, koha do të shkurtohet dhe do të rriten të ardhurat që derdhen dhe rialokohen në buxhet.

Sigurisht, nëse do të rishikohen tarifat, do të ishte shumë mirë.

Petro Koçi – Një koment nga zonja Gjylameti.

Më pas, zonja Aça do të bëjë një ndërhyrje.

Blerina Gjylameti – Kur flasim për të ardhura dytësore, destinacioni i tyre është brenda institucionit. Pra, ju prodhoni të ardhura, por ato nuk destinohen drejtpërdrejt në institucion.

Nga ana tjetër, dëgjova nga zonja Zhupa shqetësimin për *copyright*-in, marrjen apo vjedhjen e lajmeve që ju prodhoni dhe riprodhimin e tyre në portale të tjera.

Ju e keni mundësinë për të bërë kërkesë apo për të nxitur institucionin që monitoron mediet audiovizive.

Tjetra, unë do të doja të dija nëse mund të krijoni të ardhura nëpërmjet shitjes së lajmeve që prodhoni; pyeta disa herë për të ardhurat dytësore, sepse kanë shumë rëndësi.

Gjithashtu, ta përfundoj, që të mos e marr më fjalën: digjitalizimi është një proces shumë i rëndësishëm dhe normalisht ka qenë në prioritetet e qeverisë dhe një nga prioritetet kryesore të buxhetit të periudhës afatmesme. Në këtë mënyrë e kemi dhe është zëri kryesor. Unë do të doja që ju të bëni një kërkesë, e cila ta ketë të kufizuar fondin për digjitalizimin e arkivës, sepse nuk ka të bëjë vetëm me institucionin tuaj, por me atë që është memoria historike e këtij vendi dhe ju shërbeni në arkivat që ruajnë memorien historike të këtij vendi.

Ndërkohë, në anën tjetër, në kërkesën për shtim buxheti, duhet të jetë i specifikuar qëllimi për të cilin duhet ky fond dhe të kërkonti të loboni më shumë te institucioni përgjegjës, AKSHI, që bashkëpunon apo menaxhon pjesën e digjitalizimit të të gjitha shërbimeve, në shitje, blerje apo çdo shërbim tjetër që marrin qytetarët shqiptarë, për të pasur ju zërin kryesor, sepse, përderisa digjitalizimi po vazhdon me arkivat e tjera, duhet të ishte prioritet edhe digjitalizimi i arkivës së ATSH-së. Në këtë aspekt, ju duhet të bëni pjesën tuaj.

Duke qenë se jam relatore e buxhetit në Komisionin e Ekonomisë, ku ne do të shkojmë me propozime për mbështetjen përkatëse pas këtij komisioni, mendoj se pasi të marrim një specifikim të fondit që ju kërkonti, të shikojmë mundësinë, për sa kohë që është një fond relativisht jo shumë i madh. Ju mund t'ju shërbejë shumë mirë për të nisur punën, ndërkohë që nuk mund të cenohet punën e institucioneve të tjera dhe do të keni mbështetjen tonë, por duhet specifikuar pse.

Faleminderit!

Petro Koçi – Sugjerimi është i drejtë, por është i specifikuar.

Në memom e dërguar kanë shkruar se duan 5 milionë për digjitalizimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Blerina Gjylameti – Duhet procesi, për të ditur përse nevojitet digjitalizimi.

Petro Koçi – Duhet i gjithë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Enslemvera Zake – Meqenëse tarifata, siç u prezantuan nga drejtoresha, nuk janë në përputhje me çmimet e tregut, ne i propozojmë drejtorisë t'i bëjë një kërkesë Ministrisë së Financave për rishikimin e tyre, duke futur edhe zërin për shitje lajmesh. Ministria e Financave ka të gjithë kompetencën që me udhëzim të ministres së Financave të nxjerrë tarifata e reja për agjencinë.

Faleminderit!

Petro Koçi – Mund ta bëjmë edhe ne si komision kërkesën për Ministrinë e Financave ose ministres së Financave.

Zonja Açka.

Flutura Açka – Pak a shumë, për të mbështetur edhe mikeshën time, për çështjen e tarifave unë kam përvojë, sepse kam blerë shpesh foto edhe në faqe amatore, dhe, të them të drejtën, vetëm se i lutem që i dua për Shqipërinë, ata e kuptojnë se është një tirazh, të paktën në këto 30 vjet përvojë, dhe e zbresin çmimin deri në 150 euro. Nuk i di tarifën tuaj, por me shpirt më shkojnë në 150 euro, që është shtrenjtë, po ta mendosh.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është e turpshme!

Mos e vononi këtë gjë!

Nëse ju duhet ndihma jonë për të ndryshuar statutin, për të ndryshuar gjërat, urdhëroni, jemi të hapur!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Petro Koçi – Vazhdoni, zonja Açka, ju lutem!

Flutura Açka – E kisha shumë të rëndësishme këtë gjë.

Petro Koçi – Dasantila, e fundit.

Dasantila Tahiraj– E dëgjova me shumë vëmendje zonjën Zhupa.

Unë kërkoj me insistim që çmimi i këtyre tarifave, siç thotë edhe kolegja Flutura, të shkojë në çmimin ndërkombëtar, sepse këto foto nuk përdoren vetëm nga mediet brenda vendit, por edhe nga studiues dhe nga medie të tjera ndërkombëtare. Pra, të bëhet edhe kërkesë nga komisioni ynë, normalisht, që të shkojnë në çmimin europian.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit!

Mbyllet diskutimi.

I kërkoj falje zonjës Ina Zhupa, sepse e ndalova të merrte fjalën, të mos kishim inflacion mbiemrash.

Faleminderit për prezencën!

Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.11.2021, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Petro Koçi – zëvendëskryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

3. Seancë dëgjimore me drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, zotin Ardit Bido, për diskutimin në parim të projektligjit "Për Buxhetin e vitit 2022".

Marrin pjesë:

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Blerina Gjylameti, Flutura Açka, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Kastriot Piroli, Merita Bakiu dhe Luçiano Boçi.

Mungojnë:

Agron Gjekmarkaj dhe Meri Markiçi.

Të ftuar:

Ardit Bido - drejtor i Përgjithshëm i Arkivave,

Arben Dervishllari- drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave,

Endrit Musaj- drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave,

Elsa Saka – drejtore e Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave,

Gentian Opre - drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Vijon pika e tretë e rendit të ditës

Petro Koçi – Viojmë me seancën e tretë të rendit të ditës së sotme me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Përkatësisht, janë të ftuar zoti Ardit Bido, drejtor i Përgjithshëm, zoti Arben Dervishllari, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse, zoti Endrit Musaj, drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimeve dhe zonja Elsa Saka, drejtore e Drejtorisë së Evidencës Qendrore dhe Komunikimit dhe vazhdon të jetë prezent përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, zoti Opre, drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor.

Sipas mënyrës, në fillim ju do të paraqisni një strukturë të buxhetit që kërkonte, totalin e të tjera, dhe nëse ka nevojë, edhe ndonjë shtesë, siç ka ndodhur edhe me institucione të tjera. Më pas do të merrni komente nga anëtarët e komisionit.

Faleminderit!

Zoti Bido, fjala për ju.

Ardit Bido – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Ju falënderoj për mundësinë!

Dua të bëj një prezantim të shkurtër si të buxhetit të deritanishëm dhe ku është orientuar ai, ashtu edhe të buxhetit të propozuar zyrtarisht tashmë nga Këshilli i Ministrave për miratim, sikurse në fund edhe një përcaktim të shkurtër mbi një nevojë, e cila në gjykimin tonë duhet të merret parasysh në vijim nga shteti shqiptar.

Gjatë viteve të fundit kemi pasur mundësi të investojmë për çështje infrastrukturore arkivore, sepse infrastruktura e arkivit ka qenë në gjendje katastrofike deri para 2 vjetësh, ku dokumentacioni ka qenë i magazinuar në ish-kazerma ushtarake dhe jo i mirëmbajtur, çka rriste si lagështinë, që është armiku më i madh i dokumenteve ashtu edhe risqe të tjera që kanë të bëjnë qoftë me ato natyrore, siç mund të jenë ato të natyrës së zjarrit apo të kushteve atmosferike, qoftë edhe të ndërhyrjes njerëzore si rezultat i mungesës së teknologjisë së informacionit që kufizon deri diku riskun në dokumentacion.

Fatmirësisht, në bazë të teknologjisë së informacionit ka përfunduar investimi më i madh në fushën e arkivave me ndërtesën e re dhe ruajtjen e mirëfilltë arkivore, një ndër më të mirat në rajonin tonë, e cila ndodhet në Shkozë, si dhe mobilimi i saj dhe jemi në fazën e zhvendosjes së dokumentacionit, duke shpresuar të mbaroj brenda këtij viti, por mund të zgjasë edhe vitin tjetër, që të mbyllet kjo gangrenë.

Po ashtu, është investuar edhe në vendruajtje të tjera që kemi nëpër rrethe, janë 5, ku në 4 prej tyre ka përfunduar ndërhyrja infrastrukturore dhe tashmë janë për herë të parë në kushtet e nevojshme për arkiva, ndërsa sa i takon vendruajtjes së 5-të, edhe atë e kemi pasur, është financuar dhe zhvilluar procedura e prokurimit, por në zbatim të kontratës jemi detyruar ta tërheqim, sepse operatori fitues nuk i ka vijuar punimet siç duhet, gjë, e cila do të thotë se do të vijoj edhe vitin e ardhshëm.

Pra, në këtë drejtim sa i takon fushës infrastrukturore, për herë të parë mund t'ju them sot që arkivat shqiptare ruhen sipas standardeve arkivore dhe nuk rrezikohet dokumentacioni.

Sa i takon fushës së dytë, e cila ka të bëjë me shërbimin arkivor, fatmirësisht edhe aty prej vitesh digjitalizimi është në ritme mjaft të mira, duke ofruar shërbimin *onsite* dhe *online* përmes sistemeve elektronike, duke shmangur burokracitë, si dhe me një parashikueshmëri totale për studiuesin që e cakton vetë datën, dokumentet që do të shohë, të cilat edhe mund t'i blejë *online* apo t'i shohë në sallë, sepse tashmë nuk kemi vetëm sallë në Tiranë, por kemi salla që nga Prishtina, Ferizaj, Shkupi, Tetova, Kërçova e një sërë qytetesh të tjera në Shqipëri në bashkëpunim me partnerët lokalë, sepse i gjithë shërbimi ynë është i orientuar përmes sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Në të njëjtin drejtim është edhe sa i takon fototekës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila është fototeka e dytë më e madhe në vend pas asaj të Marubit, e cila është digjitalizuar në masën 80% dhe veprohet vetëm *online*. Për të parë është falas me rezolucion të ulët, ndërsa për ta blerë mund të vijohet *online*. Po ashtu, po vijon digjitalizimi i pjesës së mbetur të fototekës, duke shpresuar që në vitin 2022 do të ketë përfunduar, një proces që bëhet *in house* përtej mjeteve buxhetore, si dhe biblioteka jonë që ka sistemin e vet elektronik, shërbime të tjera si kërkesat social-juridike për efekt të qytetarëve që mund të bëhen *online* dhe përgjigjja mund t'u kthehet *online*, përveç faktit që e kemi të delokalizuar sërish përmes partneritetit me Postën Shqiptare në çdo pikë të saj, kështu që qytetarët nuk e kanë më të detyrueshme të vijnë në Tiranë për dokumentacionin që u duhet, por bëjnë aplikimin dhe u shkojnë atje ku janë.

Sa i takon projektbuxhetit afatmesëm 2022-2024, është marrë parasysh një kërkesë jona për një investim të ri. Dua të theksoj pak diferencën, sepse është ai tavani normal institucional i investimeve, që për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave është 15 milionë lekë të reja, i cili është e paraparë së paku deri në vitin 2030 se ku do të shkojë, kjo për shkak të strategjisë afatgjatë arkivore të Republikës së Shqipërisë, e cila e ka të destinuar se ku do të investohet në vijim.

Kemi mbaruar me infrastrukturën dhe tashmë do të zëvendësojmë raftet statike me rafte lëvizëse që e rrisin me 1,5 herë kapacitetin ruajtës, duke ulur koston në totalin e vet, pra në vend që të ndërtohet një godinë, kjo nuk do të jetë e nevojshme, sepse luhet brenda hapësirave ekzistuese përtej faktit që rrit mundësinë e aksesit dhe të kontrollit të orientuar, duke minimizuar disa risqe që janë të paraparë në strategji. Pjesa tjetër është për zëvendësim kompjuterësh, kondicionerësh e të tjera, pra shpenzime të mirëfillta operative, të cilat deri më sot i kemi shmangur, por mendoj se ka ardhur momenti që ta bëjmë, sepse jemi bazuar më shumë në dhurime kompjuterësh sesa në blerjen e tyre si rezultat i pamundësisë financiare.

Pra, përtej këtij tavani, që është dedikuar qartazi deri në vitin 2030 se ku shkon dhe për çfarë arsye, nëse dëshironi dhe keni interes, mund t'ju detajoj edhe më tej, është marrë parasysh edhe një kërkesë jona për një investim të ri në masën 50 milionë lekë të reja për të sistemuar një ndërtesë që gjendet pas godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, pra ndërmjet SPAK-ut dhe murit rrethues të DPA-së për ta kthyer në një muze arkivor. Në këtë kuptim mendojmë se ky është hapi final ku përfundon me gjithçka dhe arkiva bëhet ashtu siç është nëpër të gjitha vendet e botës. Muzeu arkivor është pjesë e nevojës për trashëgiminë tonë kulturore, ku ne ruajmë pasuri kulturore botërore, jo vetëm të historisë sonë kombëtare, por edhe botërore, dhe ekspozimi i tyre është një gangrenë nga pikëpamja burokratike, nëse do ta bësh në një mjedis.

Ne kemi bërë një ekspozitë të vetme origjinale dokumentare, sepse kërkon një procedurë 7-8 mujore që të mund të bësh të gjithë sigurinë që ka nevojë ky lloj procesi. Kjo është arsyeja pse të gjitha vendet e botës kanë një muze arkivor dhe në këtë formë ne shpresojmë që në 3 vjetët e ardhshëm, pavarësisht se është një financim i parashikuar për vitin 2022, në varësi të kohës, të procedurave që kërkojnë kohën e tyre dhe nuk i dihet ekzistojnë mundësitë që të shtrihet gjatë 3 vjetëve, duke tërhequr investime të parashikuara për 2 vjetët e mëvonshme në vitin aktual në mënyrë që të mos ketë rrezikun e djegies së fondit brenda të gjitha procedurave që janë të domosdoshme.

Një çështje, të cilën dua ta vendos në dijeninë tuaj si problematikë, i cili është edhe pengu im personal i vetëm në atë çfarë ka nevojë arkivi, ka të bëjë me materialin audioviziv. Këtu problematika e tejkalon Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, sepse është një problematikë e gjerë e shtetit tonë, sepse materiali ynë audioviziv është në një sasi të vogël krahasuar me institucionet e tjera, së pari.

Së dyti, këtë material nuk e kemi objektin tonë primar të punës, sepse ne jemi institucion i orientuar drejt letrës, ajo është objekti ynë i punës.

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, sipas ligjit.

Ky material është dhe duhet të jetë pjesë e arkivit, sepse është pjesë e PPSH-së, por nuk është objekti ynë primar i punës, por objekti primar i arkivit të filmit, i Radiotelevizionit Shqiptar, i Institutit Antropologjik për arkivin e vet audiovizual, që ka për efekt të trashëgimisë kulturore. Fatkeqësisht në Shqipëri ne nuk kemi investim në asnjë prej këtyre institucioneve për të pasur pajisjet e skanimit të atilla për materialet që edhe ne të mundeshim, edhe pse ne i kemi në sasi të vogla, relativisht të vogla, sepse nuk janë aq të vogla përkundrejt tyre, ta mbyllim punën me ta, ashtu sikurse po bëjmë sot me fototekën.

Ne po e bëjmë sot fototekën *in house* falë skanerëve që na i ka sjellë dhe do t'ia kthejmë prapë Marubit, sepse ata kanë fotografinë objekt primar, ndërsa ne kemi letrën, ata na sjellin skanaera dhe kanë trajnuar stafin, ndërsa ne po e bëjmë skanimin dhe po ua kthejmë.

Fatkeqësisht, institucionet e tjera nuk kanë të gjitha pajisjet e nevojshme për skanimin e modeleve të ndryshme të materialit audioviziv. Arkivi i filmit ka disa skanera, por ato nuk shërbejnë për të gjitha llojet e materialit audioviziv. Ky material audioviziv kryesisht është nga fondi i ish-arkivit të partisë, disa prej këtyre materialeve janë të fshira që në të atë kohë, ndërkohë që ekziston teknologjia, por shihet vetëm në praktikë nëse mund të realizohet, për t'i rigjurmuar. Sa u takon këtyre materiale ne kemi një kureshtje shumë të madhe historike të dimë se si një regjim që regjistronte gjithçka, madje edhe krimet e veta, çfarë mund ta shtynte të fshinte disa kasete, janë gjithsej 16 kasete, por në kuptimin historik është pjesa më interesante.

Po ashtu janë edhe mbledhjet e Këshillit të Ministrave nga vitit 1945 deri në vitin 1990, sikurse janë edhe mbledhjet e organeve të partisë përgjatë gjithë periudhës, një pjesë e tyre janë të skanuara në formë legale ose ilegale, sepse i shohim nëpër media...

(Diskutime pa mikrofon)

Janë digjitalizuar ndër vite, janë shfaqur mediatikisht, por arkivi nuk i ka.

Një pjesë e tyre nuk janë digjitalizuar (ndjesë se kam përdorur në vazhdimësi termin e gabuar). Ajo çka kemi vënë re në elementet e digjitalizimit është diçka që e dimë nga dokumentacioni dhe kujtimet, se shpeshherë çfarë është thënë nuk është shfaqur në procesverbal ashtu siç është thënë, sidomos kur bëhet fjalë për drejtuesin e nomenklaturës, Enver Hoxha, i cili kërkonte t'i futeshin në mendim dhe jo në fjalë. Në kuptimin historik kjo përbën një interes të veçantë për të kuptuar çfarë është thënë realisht përkundrejt asaj që kemi të shkruar në procesverbal, përtej atyre që janë të shkruara dhe përtej materialit të Këshillit të Ministrave, ku janë të gjitha mbledhjet e qeverisë që nga viti 1945 deri në vitin 1990. Problematika këtu qëndron se materiali është organik dhe rrjedhimisht i degradueshëm dhe i humbshëm.

Sivjet kemi kërkuar në Ministrinë e Financave, nuk kam gojë të flas për Ministrinë e Financave, sepse na ka mbështetur në vijimësi, këtu dua të jem i sinqertë dhe dua ta falënderoj, sepse projektet që u kemi dërguar janë vlerësuar si të nevojshme, në gjykimin tonë kanë qenë të nevojshme dhe ky është rasti (sepse vitin tjetër ne do të vijmë dhe do t'ju themi: ky lloj materiali po vdes), sepse gjithë këto vite kemi pritur arkivin e filmit ose RTSH-në, sepse nëse ata do të kishin aparaturat e nevojshme për digjitalizim kjo do të kishte qenë e thjeshtë. Në pamundësi të kësaj, pra të faktit që ne të blejmë aparatura digjitalizimi për materiale audio ose video, është diçka që nuk mund ta bëjmë në shumë drejtime.

E para, është një investim i kotë, sepse është diçka që do të mbyllet për 3 vjet dhe do të mbetet aparatura pa asgjë, së dyti, ne kemi stafin, sepse të specializuarit për materialin audioviziv janë tek Arkivi i Filmit dhe RTSH-ja, jo te ne. Pra, në një sërë drejtimesh është e pamundur. Ajo që kemi parë në këto vite është mundësia e kalimit me shërbim digjitalizimi të jashtëm, i cili, përtej faktit na ka rezultuar i suksesshëm në digjitalizimet e tjera, që do të bëjmë edhe në dokumentin letër, është e vetmja formë që kemi parë të mundshme. Kemi pasur kontakte me shoqëri në Izrael dhe Itali, që merren me këtë punë, sepse në Shqipëri nuk ka, na kanë sjellë propozimet e tyre, gjithashtu, një personalitet izraelit në këtë fushë, një kurator i njohur izraelit ka sjellë dhe propozimin e tij. E dimë sa shkon, është një shumë prej 30 milionë lekësh të rinj, por që mund të ndahet në tre vjet, sepse nuk bëhet dot brenda vitit, ose, nëse do të kishte një investim RTSH-ja dhe Arkivi i Filmit, do të operonim, siç i ndihmojmë ne për letrën ose, siç na ndihmon ne “Marubi” për fotografinë.

Kështu që, e vetmja çështje që unë ngre është kjo, sepse vitin tjetër është e sigurt që përfaqësuesit e Arkivit do të vijnë me ulërima që po humbet ai material dhe duhet ndërhyrë urgjentisht. Sivjet po e ngremë si çështje dhe nëse e gjykon komisioni mund të vijojmë më tej.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Bido!

Së pari, dua të mbështes zhvillimet e fundit në Arkivë lidhur me modernizimin e infrastrukturës, sidomos me modernizimin e shërbimit. Shërbimet *online* janë të domosdoshme në një sistem arkivor.

Ajo që ju thatë në lidhje me çështjen e digjitalizimit të të gjithë arkivit, sidomos në pjesën audiovizive, besoj se duhet parë në mënyrë integrale, duhet parë çfarë keni ju, çfarë ka RTSH-ja, çfarë ka edhe ATSH-ja, sepse fototekë kishin edhe ata, filmi e me radhë. Unë mendoj se duhet një projekt i përbashkët, në mënyrë që të jemi më ekonomikë. Megjithatë, nuk e kemi mundësinë të japim përgjigje sot. Kjo duhet shqyrtuar me institucionet e tjera, pa dyshim me

qeverinë, madje me Ministrinë e Kulturës, që është lojtari që integron këto interesa të shumë institucioneve, që në natyrë janë të pavarur nga organet buxhetore, por i bashkon të gjithë interesi ynë kombëtar. Këtu kemi të bëjmë me një pasuri të jashtëzakonshme kombëtare.

Kush ka pyetje?

Po, zonja Tahiraj.

Dasantila Tahiraj – Dëgjova me vëmendje zotin Bido. Dua të vlerësoj atë që është bërë në arkiva këto vite për transformimin jo vetëm të Arkivit Qendror, që unë kam pasur rastin ta shikoj, është vërtet një godinë dinjitoze dhe ashtu duhet të jenë të gjitha arkivat, sepse me të vërtetë arkivat nuk flasin, por ato janë trashëgimia jonë kulturore, trashëgimia pasurore, që na tregojnë se çfarë kemi bërë në vite si komb dhe si njerëz. Është me shumë interes rikonstruksioni i kësaj godine, pa dyshim, sepse do të jetë një muze i fondeve arkivore. Por, a është e mjaftueshme kjo vlerë për të realizuar mbrojtjen nga zjarri, pra mbrojtjen e atyre fondeve arkivore? Sepse janë shumë të rëndësishme, janë pjesë e kulturës sonë dhe një fond arkivor, që mund të dëmtohet apo humb, merr me vete historinë që ai tejçon, apo është vetëm fillimi i një projekti?

Kjo është pyetja ime për zotin Bido.

Ardit Bido – Faleminderit!

Para se të kthej përgjigje për pyetjen, dua të shpreh edhe mendimin tim për bashkëpunimin. Jam shumë dakord me atë që tha zëvendëskryetari, që ky duhet të ketë bashkëpunim. Ky duhet të ishte ose një projekt i përbashkët, ose i atyre që kanë arkivin e madh, sepse, sikurse ne bëjmë për arkivin dokumentarë dhe ndihmojmë, në fund të ditës me të vërtetë jemi institucione të pavarura, por jemi të një shteti, ndihmojmë njëri-tjetrit, prandaj nuk e kemi kërkuar gjithë këto vite, pavarësisht se e shohim si problematikë. Nëse kjo do të zgjasë edhe një vit, rrezikohet të mos digjitalizohet më.

Sa i përket pyetjes për çështjen e sigurisë nga zjarri, nga lagështia e kështu me radhë, arkivat sot i kanë të gjitha kushte, sepse vendruajtjet arkivore janë thelbi i muzeut. Para se të bënim investimin, kemi bërë disa reforma, kemi bashkuar në vendruajtje të ndërtuara për arkiv, për shembull, arkivat vendore, sepse përndryshe kostoja do të duhej 18 milionë euro, ndërkohë që është bërë me 3 milionë euro. Ka diçka, sa më shumë para të kesh, aq më shumë gjëra bëhen, por ne nuk kemi kërkuar këtë gjë. Ne kemi kërkuar të bëjmë shumë gjëra të nevojshme dhe të domosdoshme, duke e parë atje nivelin që kërkojmë. Në këtë kuptim shifra që ne kemi kërkuar sot, nuk jemi ende të bindur, do të presim projektin, kur të finalizohet në bazë të procedurave përkatëse, nëse kjo shifër të na mjaftojë edhe për muzealizimin, ose do të jetë thjesht ndërhyrje infrastrukturore, i cili është hapi i parë drejt muzalizimit. Pra, ne do të vijmë të krijojmë kushtet,

ku pa dyshim nuk do të ketë rrezik për zjarrin dhe lagështinë, për të parë pastaj nëse ka hapësirë edhe për muzealizimin. Nga çfarë kemi në detyrën e projektimit, na rezulton se ka hapësirë.

Pjesa e dytë është që muzealizimi është i pafund. Muzealizimi është i pafundmë edhe në atë se çfarë do të bësh, mund të përdorësh shumë teknologji informacioni me më shumë kosto, mund të bësh diçka të ndërmjetme. Ajo që ndryshon muzeun e mirëfilltë nga muzeu arkivor, që është specifik, është se muzetë arkivorë, përveç një ekspozimi të punës në arkiva dhe të pasurisë më të madhe dokumentare, janë njëherazi salla që përdoren për ekspozita për përkohshme se të përhershme. Pra, ekspozita e përhershme është një hijeshi, që shoqërohet me ekspozimin e përkohshëm të pasurisë dokumentare të vendit dhe këtu kostoja është më e ulët se do të donte Muzeu Historik Kombëtar.

Petro Koçi – Me gjithë standardet e ruajtjes.

Faleminderit!

A ka pyetje?

Po, zoti Ajazi.

Besion Ajazi – Kam një koment të shkurtër, por edhe një pyetje.

Sigurisht, pas fjalëve tuaja dhe të koleges Tahiraj, do të duket ndoshta edhe si festival falënderimesh, por realisht Drejtoria e Arkivave në tërësi i meriton këto falënderime, sepse është puna e këtyre viteve që e tregon këtë, pra një punë për digjitalizimin e arkivit në tërësi. Unë mendoj se ka ndikuar për mirë edhe te qytetarët e thjeshtë, por edhe te studiuesit që e aksesojnë këtë proces, ose si nevojë, ose si domosdoshmëri.

Për t'u përgëzuar është edhe ndërtimi i godinës së re për ruajtjen e dokumenteve arkivore. Është shumë e rëndësishme, ashtu siç edhe ju e thatë, që ta ruajmë këtë pasuri të madhe që kemi, por edhe ta bëjmë sa më të aksesueshme nga njerëzit, studiuesit dhe ata që kanë nevojë t'i studiojnë këto dokumente. Sigurisht, muzeu është diçka shumë e mirë, por kërkon kohën e vet dhe fondet e veta. Unë besoj se edhe kolegët që janë pjesë e këtij sektori, në një formë, do ta mbështesin këtë kërkesë.

Unë dua të di: a ka pasur ndikim ky modernizim dhe digjitalizim në rritjen e numrit të personave që e kanë aksesuar sistemin? Sa është thjeshtuar si procedurë në mund dhe në kohë? Unë dua t'i di këto, me qëllim që t'i mbështesim pastaj këto projekte, duke ditur që ka thjeshtim të procedurave, ka ulje të kohës, ka edhe rritje të numrit të personave që aksesojnë.

Faleminderit!

Petro Koçi - Po, zoti Bido.

Ardit Bido – Faleminderit!

Pyetjen do ta ndaj në tri kategori, se për çfarë shërben muzeu: studiuesit, që është kategoria kryesore, në kuptimin ligjor; qytetarët, që janë kategoria më e rëndësishme në kuptimin praktik, por janë për faktin që ne kemi trashëgimi të keqe shtetformuese, pra për atë që qytetarët kërkojnë te ne, që janë dokumentet pronësore, që duhet t'i gjenin te hipotekat, por, për shkak të problematikës shumë të gjatë me pronat, duhet t'i marrin edhe në arkiv, jo thjeshtë nga arkivi i hipotekës, që funksionon gjithmonë më vete, ose amza shkollore për shkak të problematikave që ka me dëmtimet e amzave në shkolla, ose vitet e punës që duhej të ishin tek ISSH-ja, por për shkak të se nuk janë atje duhet të marrin vendimet e emërimit te ne, kjo është kategoria që ligjërisht nuk duhet të kishte punë me arkivin, por praktikisht është puna më e rëndësishme, sepse i bën dëm qytetarit; kategoria e tretë është ajo administratës për të garantuar që institucionet të dorëzojnë dokumentacionin, sepse ne prodhojmë historinë.

Në këtë kuptim, sa u përket studiuesve, kemi tentuar dhe kam tentuar, këtë po e kthej në personale, të vendos disa parime bazike, shërbimi i njëjtë për të gjithë, sepse kjo ishte problematika më e madhe; shërbim i shpejtë dhe i parashikueshëm. Kjo do të thotë se, nëse në sallën e leximit, edhe unë si studiues dikur, mund të shkoja dhe nëse njihja dikë mund të më dilte dosja brenda dy ditësh ose për ndryshe për tri javë, sot nuk ka njeri që mund ta bëjë këtë gjë, sepse është sistemi elektronik që ta pamundëson. Dikush kërkon dosje që do dhe ka i 5 ditët e bllokuara në kalendarin elektronik, duhet të zgjedhë ditën e 6-të dhe e mbush atë për vite të tëra. Pra, thjesht i themi që kërko njëherë çfarë dosjesh do, pastaj hajde në sallë, mos e bëj paralelisht, por këtë e cakton vetë. Ajo që është e sigurt është se ditën që ai e ka kërkuar, e ka në sistem elektronik ose nëse nuk kemi kapacitet, sepse skanojmë 12 mijë dokumente jo më shumë. E kanë origjinal, atë ditë që e ka, e ka paraprakisht në sallën e studimit në çfarëdolloj ore që vjen. Kemi hapur sallën e studimit për pasdite dhe tashmë kemi bërë diçka, që nuk e kemi hasur në arkiva të tjerë, thjesht na doli që mund ta bënim dhe pse jo, po e hapim në të gjithë Shqipërinë. Kemi jo vetëm në qytetet kryesore: në Çorovodë, në Delvinë, në Selenicë, kudo ku na janë përgjigjur bashkitë e qyteteve për bibliotekat, që u kemi thënë vendosni dy kompjuterë, tri tabela, ndërsa shërbimin e organizojmë ne pastaj, nuk na duhet gjë tjetër, na duhet thjesht bashkëpunim, se nuk mund të blejmë 500 kompjuterë, kur bashkitë mund t'i kenë 2 kompjuterë.

Ka bashki që nuk na janë përgjigjur, por tek ato bashki që na janë përgjigjur, ne kemi shkuar. Ju thashë, kemi shkuar edhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, do të shkojmë në Ulqin, Tuz, brenda këtij viti do të jemi në Horën e Arbëreshëve, do të jemi në Shën Mitër në Kalabri, jemi në kontakt në Budapest, në Katedrën e Albanologjisë. Pra, po tentojmë ta delokalizojmë, ta barazojmë për të gjithë dhe të mos ketë nevojë njeri të dijë emrin e drejtorit

të Përgjithshëm, të drejtores së Komunikimit, që e drejton atë, apo qoftë edhe të punonjësve të sallës.

Në sallën tonë të studimit, një studiues merr kartën, futet në kompjuterin e vet, ka dokumentacionin e tij dhe mund të mos i flasë askujt.

Çfarë ka sjellë kjo? Ka sjellë ulje të moshës mesatare. Nuk ju them dot nëse ka sjellë rritje, dhe sa rritje ka sjellë, sepse kemi ndaluar në sallën e studimit njerëz që vijnë për efekt të kërkesave social-juridike, pasi në shumicën e rasteve këta njerëz kanë qenë sekserë, që vinin, shihnin për 10 veta, u thoshin atyre “shiko, unë ta gjeta, më jep ndonjë lekë mua!”, ka vijuar kjo lloj historie. Kjo është diçka që unë nuk e denoncoj dot zyrtarisht në organet ligjore, sepse nuk e faktojme dot, por që është një fenomen i shëmtuar, që ka ndodhur vazhdimisht: njerëzit vinin dhe kërkonin pronat e 20 vetëve, pa lidhje me interesat e tyre, kryesisht avokatë. Kështu që, ne e kemi kufizuar atë gjë. Numri i studiuesve është rritur në total me 20%. Se sa është rritur *de facto*, duhet bërë llogaria, se sa kanë ikur nga këta dhe sa janë studiues realë.

Procesi i dytë, që është social-juridik, është i barabartë për çdo qytetar, ka procedurë të zakonshme dhe të përshpejtuar, dikush i cili e do shpejt dokumentacionin, brenda 2 ditëve, do të paguajë më shumë lekë në çdo pikë poste të autorizuar të Shqipërisë apo *online* dhe e ka brenda aq ditëve. Dikujt që i pret puna, shkon gjatë, fatkeqësisht, për dokumentacionin, deri në 23 ditë, sepse bëhet kërkimi në arshivë, bëhet “kërkimi i gjilpërës në kashtë”. Kush e do shpejt, e ka për 5 ditë. Këtu diferencon, në kuptimin e dhënies së shërbimit, por ka qartësi se kur merret përgjigje, ajo për 23 ditë nuk jepet ditën e 22, sepse edhe kjo është për të minimizuar riskun e korrupsionit apo abuzimit që ti mund të bësh pagesë të ulët dhe e merr më herët sesa dikush tjetër. Pra, ka barazi.

Si ka ndikuar? Parametrat që unë shoh janë këto: sa ankesa kam? Kur është konsoliduar kjo procedurë, sepse është vendosur para 4 vjetësh dhe është konsoliduar para 3 vjetësh, numri i ankesave ka rënë mesatarisht nga 30-40 në muaj, tani po të kemi një në 4 muaj. Ky është rast i veçantë dhe kjo tregon besueshmëri procesi dhe besueshmërinë që përgjigja të jepet saktë.

Është ndërtuar një procedurë e atillë, shumë burokratike, në kuptimin e brendshëm, pra atë të kontrollit hierarkik, janë 8 palë sy për të njëjtën procedurë dhe kjo na ka bërë që afati të jetë i lartë, por brenda VKM-së, sepse është kërkimore dhe ajo thotë se maksimumi është 23 ditë, kaq e ka edhe Britania, për të bërë paralelizmin, se unë jam komod me këtë gjë. I kemi dhënë mundësinë edhe procedurës së përshpejtuar dhe nuk kemi ankesa, unë e kam shumë të rëndësishme këtë gjë, ne jemi përballë qytetarëve, që në fund të ditës kërkojnë vendimin e emërimit për të dalë në pension, kërkon dokumentacionin e shkollës për të shkuar në ambasada apo për të filluar punë, apo dokumentacionin pronësor për të marrë pronën e vet.

E treta, edhe këtu jemi rixhidë, nëse tek e para jemi teknologjikë, të hapur edhe në mundësi, këtu jemi rixhidë, më mirë të shihet nga 8 palë sy, për të minimizuar sidomos riskun e korrupsionit dhe risqet e tjera që shoqëron dhe për të evidendua barazi që të mos m'i bjerë dikush mua telefonit apo askujt tjetër për një shërbim që qytetari nuk ka nevojë t'i bjerë telefonit, se sa të ishim më të lehtë në dhënien e shërbimit por që do të kishte riskun siç ka qenë.

Për sa u përket institucioneve, ne jemi inspektorat shtetëror, kryesisht administrativ, jo kulturor. Në këtë drejtim institucioni ka një përmirësim të vazhdueshëm që në çastin që ne jemi bërë inspektorat shtetëror ne kemi të drejtën të vendosim gjoba ndaj titullarëve të institucioneve dhe drejtuesve të sekretari-arkivave. Gjjobat janë të nominuara sipas legjislacionit.

Ka rritur edhe sasinë e dokumentacionit të shtimit të një procedure burokratike, është rritur edhe cilësia, duke mos dorëzuar më badihava çfarë kishin institucionet si dokumentacion, që, në fakt ,e bën atë më të pagjetshëm dhe e ngarkon arkivin me kosto, por duke ulur sasinë në atë çfarë është realisht RHK në legjislacionit tonë.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit, zoti Bido!

Dasantila Tahiraj - Duke iu referuar materialit tuaj, shikoj që arkiva e Lushnjës, që ju e dini shumë mirë, mbulon tri qarqe: Fier, Gjirokastër dhe Vlorë. Është një ndërtesë në qendër të qytetit, gjigante, e para viteve '30. Ka 17,3 milionë lekë në dispozicion për ndërtimin dhe përfundimin e saj në fund të vitit 2021.

Mendoj se, duke parë edhe anën e arkitekturës së arkivës, ky mund të jetë një financim pjesor. E para.

E dyta, nga të ardhurat dytësore, a keni planifikuar pajisje brenda, se më ka lindur shpesh nevoja të futem aty dhe nuk u përgjigjet tri qarqeve mënyra e pajisjes dhe mobilimit aty.

Ardit Bido – Ky është rasti që, informacioni është pak i tejkaluar tashmë, ju thashë që ka pasur mosmarrëveshje me kompaninë, që është tërhequr dhe procedura do të rihidhet dhe do të vijojë në vitin 2022.

Për rikonstruksionin besoj se është e mjaftueshme, si për brenda dhe për fasadën, ato janë vend ruajtjeje, janë ndërtuar për arkiva, dhe kjo është “a-ja” që na ul kostot, nuk kemi nevojë të ndërhyjmë për elementet mirëfilli arkivore, dhe ne po ndërhyjmë për sistem aspirimi, për sistemin e ndriçimit, për uljen e brendshme dhe uljen e lagështirës si dhe ndërhyrjen në fasadë. Fasada do të përfundojë sivjet, se ka qenë projekt më vete, për brenda i bie që do të vijojë vitin e ardhshëm.

Për të ardhura dytësore ne kemi shumë pak të cilat janë të orientuara në dixhitalizim, ndërsa nuk besoj se nuk ka nevojë për ndërhyrje, me përjashtim të ndërhyrjeve të vogla, sepse ato janë zyra ruajtjeje për 4 vetë, që do të thotë 2 tavolina, kuptohet kompjuterët i kanë, por nuk besoj se kanë ndërhyrje të mëtejshme në këtë drejtim.

Faleminderit!

Petro Koçi – Faleminderit!

Zonja Aça.

Flutura Aça – Faleminderit, zoti Bido për gjithçka, si dhe për punën tuaj të lavdërueshme në sytë e mi!

Ju para disa kohësh keni takuar 2 holandezë, që do të sjellin arkivën e Holandës, e cila do të digjitalizohet enkas edhe për Shqipërinë. Unë, në fakt, jam rropatur vite të tëra për ta sjellë atë arkivë këtu, por askush nuk m'u përgjigj, ç'është e vërteta. Bëhet fjalë për 50 dosje të lidhura me historinë e vitit 1914; unë kam punuar për interesat e mia letrare, por askush nuk m'u përgjigj. Kështu që, më vjen keq që kemi ardhur në një ditë që na mungon kjo arkivë kaq e rëndësishme, por do të vijë dita që do të vijë te ju.

Kisha një pyetje: krahasuar me arkivat e tjera në botë, a mund të vendoset një sistem tarifimi, nëse është e mundur, sepse ka njerëz, unë, për shembull, që nuk do ta kisha fare problem ta paguaja atë tarifë, kur e di që informacioni që marr më vlen shumë?! Doja thjesht ta di nëse e keni këtë krahasuar me arkivat e tjera ose nëse do të mund të aplikohet?

Faleminderit!

Ardit Bido – Faleminderit, për vlerësimin!

Edhe ne jemi shumë të interesuar për dokumentacionin tonë të misionit holandez në Shqipëri. I kemi qëndruar forcërisht këtij parimi, e ke falas për ta parë, po ta sjellim në Selenicë madje, jo më në Tiranë. Në Tiranë do të japim edhe kartën tënde falas, po e humbe, do të paguash. Hyr, mbaro punë pa na takuar. Nëse do ta blesh dokumentin, blije. Ka qenë 20 lekë prej 20 vitesh. Na qahen edhe për atë 20 lekëshin, të jemi të sinqertë, kemi edhe debate të këtij lloji. Ne të mundësojmë që ta blesh me kartë, në sistem, blije me *sms* tashmë dhe mbaro punë pa na kontaktuar ne. Ky është parimi. Pra, falas për ta parë, mbaj shënime nëse do, unë si studiues mbaj vetë shënime dhe nuk marr dokumente në shtëpi, por ama do ta blesh dokumentin, qoftë edhe për ta printuar sa gjithë ky pallat, sepse skanimi është në ato nivele. Këtu jemi komodë, sepse ne jemi thjesht shërbyes, nuk hyjmë fare në kërkesat individuale të studiuesve të ndryshëm.

Petro Koçi - Faleminderit!

Këtu mbyllet mbledhja. Unë kisha vetëm diçka, në emër të vigjilencës kombëtare, që arkivat kombëtare duhen parë jo vetëm nga rreziqet e natyrës, por edhe nga rreziqet subjektive. Të mos harrojmë që ne jemi një popull që shumë herë na kanë sulmuar për të na lënë pa histori. Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA